



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2026

PËR SHËRBIMET DIGJITALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË¹

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi i ligjit

- Qëllimi i këtij ligji është të kontribuojë në mirëfunksionimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë, duke vendosur rregulla të harmonizuara për një mjedis online të sigurt, të parashikueshëm dhe të besueshëm, që promovon inovacionin dhe mbron të drejtat themelore të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, përfshirë parimin e mbrojtjes së konsumatorit.
- Ky ligj përcakton rregulla për ofrimin e shërbimeve ndërmjetëse në Republikën e Shqipërisë, të harmonizuara me praktikën e Bashkimit Evropian dhe krijon në veçanti:

¹ Ky projektakt është përafëruar pjesërisht me Rregulloren e (BE) 2022/2065 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19.10.2022, mbi një treg të vetëm për shërbimet digjitale dhe ndryshimin e Direktivës 2000/31/EC (Akti i Shërbimeve Digjitale); Numri CELEX 32022R2065, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 277, datë 27.10.2022, pp. 1–102

- a) një kuadër përjashtimi të kushtëzuar nga përgjegjësia, për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse;
- b) rregulla për detyrime specifike për kujdesin e duhur, të përshtatura sipas kategorive të ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse;
- c) rregulla për zbatimin dhe garantimin e zbatimit të këtij ligji, përfshirë ato në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, të harmonizuara me praktikën e Bashkimit Evropian.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për shërbimet ndërmjetëse që ofrohen për marrësit e shërbimeve që janë themeluar ose ndodhen në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht se ku është themeluar ofruesi i këtyre shërbimeve.
2. Ky ligj nuk zbatohet për çdo shërbim tjetër që nuk është shërbim ndërmjetësimi, ose për ndonjë kërkesë të lidhur me një shërbim të tillë, pavarësisht nëse shërbimi ofrohet përmes përdorimit të një shërbimi ndërmjetësimi.
3. Ky ligj nuk çënon zbatimin e ligjit nr. 10128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”, të ndryshuar.
4. Ky ligj nuk çënon rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, që rregullon aspekte të tjera të ofrimit të shërbimeve ndërmjetëse, ose që specifikon dhe plotëson rregullimet sipas këtij ligji, veçanërisht në fushat si më poshtë:
 - a) shërbimet e medias audiovizive, sipas ligjit nr. 97/2013 të ndryshuar;
 - b) e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, sipas ligjit nr. 35/2016 të ndryshuar;
 - c) parandalimin e përhapjes së përmbajtjes terroriste në internet;
 - ç) tregtimin dhe përdorimin e prekursorëve të eksplozivëve;
 - d) promovimin e transparencës dhe konkurrencës së ndershme për përdoruesit biznes të shërbimeve të ndërmjetësimit online;
 - dh) mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produktit;
 - e) mbrojtjen e të dhënave personale sipas ligjit nr. 124/2024, dhe Kreut XIX, të ligjit nr. 54/2024 për komunikimet elektronike;
 - ë) bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet civile, sipas Kodit të Procedurës Civile të Shqipërisë;
 - f) bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet kompetent” nënkupton autoritetet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 49, të këtij ligji, dhe që bazuar në legjislacionin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë së tij, është përgjegjës për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.
2. “I konsiderueshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë” nënkupton lidhjen ndërmjet një ofruesi të shërbimeve ndërmjetëse dhe territorit të Republikës së Shqipërisë, që rrjedh

nga fakti se ofruesi është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, ose nga kritere specifike faktike, si:

- a) ofruesi ka një numër të konsiderueshëm të marrësve të shërbimit në Republikën e Shqipërisë në lidhje me popullsinë ose,
 - b) veprimtaria e tij është e synuar për Republikën e Shqipërisë.
3. “Konsumator” është çdo person fizik që vepron për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, biznesin, zanatin ose ushtrimin e profesionit të tij.
 4. “Kontratë në distancë” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në pikën 22, të nenit 3, të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, të ndryshuar.
 5. “Komunikim tregtar” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 3, të Ligjit Nr. 10128/2009 “Për tregtinë elektronike” të ndryshuar.
 6. “Koordinatori i Shërbimeve Digjitale” është organi rregullator i pavarur i përcaktuar si Koordinatori i Shërbimeve Digjitale në përputhje me nenin 49, dhe sipas kritereve të përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji.
 7. “Kushtet dhe termat” nënkuptojnë të gjithë termat, pavarësisht emërimit ose formës së tyre, që rregullojnë marrëdhënien kontraktore ndërmjet ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse dhe marrësve të shërbimit.
 8. “Marrës aktiv i një platforme online” nënkupton një marrës shërbimi që ka ndërvepruar me një platformë online ose duke kërkuar hostimin e informacionit në platformën online, ose duke u ekspozuar ndaj informacionit të hostuar në platformën online dhe është shpërndarë përmes ndërfaqes së saj online.
 9. “Marrës aktiv i një motori kërkimi online” nënkupton një marrës shërbimi që ka vendosur një pyetje në një motor kërkimi online dhe i është ekspozuar informacionit të indeksuar të paraqitur përmes ndërfaqes së tij online;
 10. “Marrës i shërbimit”, është çdo person fizik ose juridik që përdor një shërbim ndërmjetës, veçanërisht me qëllimin e kërkimit të informacionit ose të bërjes së tij të aksesueshëm.
 11. “Moderimi i përmbajtjes” nënkupton veprimtari, të automatizuara ose jo, që ndërmerren nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, në veçanti me qëllimin e zbulimit, identifikimit dhe trajtimit të përmbajtjes së paligjshme ose informacionit të papajtueshëm me kushtet dhe termat e tyre, të ofruar nga marrësit e shërbimit, duke përfshirë masat e marra që ndikojnë në disponueshmërinë, shikueshmërinë dhe aksesimin e kësaj përmbajtje apo informacioni të paligjshëm të tilla si kufizimi, çmonetizimi, çaktivizimi i aksesit ose heqja e asaj përmbajtjeje apo atij informacioni, ose në marrjen e masave që ndikojnë në aftësinë e përdoruesve të shërbimit për të ofruar atë informacion, siç është mbyllja ose pezullimi i llogarisë së përdoruesit.
 12. “Motor kërkimi në internet” nënkupton një shërbim ndërmjetës që u lejon përdoruesve të vendosin kërkesa në parim, për të kërkuar, në të gjitha faqet e internetit ose faqet e internetit në një gjuhë të caktuar në bazë të një kërkesë për çdo subjekt në formën e një fjale kyçe, komande zanore, shprehjeje ose e dhënë tjetër dhe që ofron rezultate në çdo format në të cilin mund të gjenden informacione që lidhen me përmbajtjen e kërkuar;
 13. “Ndërfaqe online” nënkupton çdo program kompjuterik ‘*software*’, përfshirë një faqe interneti ose pjesë të saj, dhe aplikacione, përfshirë aplikacionet për celularë.
 14. “Personat me aftësi të kufizuara” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

15. “Përmbajtje e paligjshme” nënkupton çdo informacion që, vetë ose i lidhur me një veprimtari, duke përfshirë shitjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve, nuk është në përputhje me ligjin, pavarësisht nga objekti konkret apo natyra e atij ligji;
16. “Platformë online” nënkupton një shërbim ‘*hosting*’ që, me kërkesë të një marrësi të shërbimit, ruan dhe shpërndan informacion për publikun, përveç rastit kur kjo veprimtari është një veçori e vogël dhe thjesht ndihmëse e një shërbimi tjetër ose një funksion i vogël i shërbimit kryesor dhe, për arsye teknike dhe objektive, nuk mund të përdoret pa këtë shërbim tjetër, dhe integrimi i veçorisë ose funksionit në atë shërbim tjetër nuk është një mjet për të anashkaluar zbatimin e këtij ligji;
17. “Qarkullim” nënkupton totalin e të ardhurave të realizuara nga një ndërmarrje mbi bazë vjetore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
18. “Reklamë” nënkupton informacionin e projektuar për promovimin e mesazhit të një personi fizik ose juridik, i paraqitur nga një platformë online në ndërfaqen e saj online kundrejt shpërblimit, për qëllime tregtare ose jo, me qëllimin specifik të promovimit të atij informacioni.
19. “Sistem rekomandues” nënkupton një sistem plotësisht ose pjesërisht të automatizuar, i përdorur nga një platformë online për t’u sugjeruar marrësve të shërbimit në ndërfaqen e saj online, informacion specifik ose për t’i dhënë përparësi atij informacioni, përfshirë një rezultat të kërkimit të inicuar nga marrësi i shërbimit ose ndryshe duke përcaktuar rendin ose rëndësinë relative të informacionit të shfaqur.
20. “Shërbim i shoqërisë së informacionit” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në pikën 70, të nenit 4, të Ligjit Nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
21. “Shërbim ndërmjetësimi” nënkupton një nga shërbimet e shoqërisë së informacionit si më poshtë:
 - a) “Transmetimi i thjeshtë” ‘*mere conduit*’, është shërbimi i transmetimit përmes një rrjeti komunikimi, të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, ose për sigurimin e aksesit në një rrjet komunikimi;
 - b) ‘*Caching*’ është shërbimi që konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga një marrës i shërbimit, që përfshin ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të atij informacioni, të kryer me qëllimin e vetëm për ta bërë më efikas transmetimin e mëtejshëm të informacionit të marrës të tjerë me kërkesën e tyre;
 - c) ‘*Hosting*’ është shërbimi që konsiston në ruajtjen e informacionit të dhënë nga një marrës i shërbimit me kërkesën e tij ose të saj;
22. “Shpërndarja për publikun”, nënkupton vënien e informacionit në dispozicion të një numri potencialisht të pakufizuar palësh të treta, me kërkesë të marrësit të shërbimit që ka dhënë informacionin.
23. “Të ofrojë shërbime në territorin kombëtar” nënkupton mundësimin që personat fizik ose juridikë të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë të përdorin shërbimet e një ofruesi të shërbimeve ndërmjetëse që ka një lidhje të konsiderueshme/thelbësore me territorin e Republikës së Shqipërisë;
24. “Tregtar” do të thotë çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nëse është në pronësi private apo publike, i cili vepron, vetë apo nëpërmjet çdo personi tjetër që vepron në emrin ose në llogari të tij, për qëllime që lidhen me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij;

KREU II

REGJIMET E PËRGJEGJËSISË PËR SHËRBIMET E NDËRMJETËSIMIT

Neni 4

Kanali i thjeshtë transmetimi ‘*Mere Conduit*’

1. Kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit, konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit, ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, ofruesi i shërbimit nuk mban përgjegjësi për informacionin e transmetuar ose të aksesuar, nëse ofruesi:
 - a) nuk inicion transmetimin;
 - b) nuk zgjedh marrësin e transmetimit; dhe
 - c) nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit që transmetohet.
2. Veprimet e transmetimit dhe të ofrimit të aksesit, sipas pikës 1, të këtij neni, përfshijnë ruajtjen automatike, të ndërmjetme dhe të përkohshme të informacionit të transmetuar, për atë kohë sa ruajtja shërben ekskluzivisht për përcjelljen e transmetimit në rrjetin e komunikimit dhe me kusht që kohëzgjatja e ruajtjes të mos e tejkalojë kohën e nevojshme të arsyeshme për të kryer transmetimin.
3. Ky nen nuk cënon mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, t’i kërkojë ofruesit të shërbimit ndërprerjen, ose të parandalojë një shkelje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Ruajtja e përkohshme e informacionit “*Caching*”

1. Kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi, të informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit që ofron transmetimin nuk është përgjegjës për ruajtjen e përkohshme, të ndërmjetme dhe automatike, të atij informacioni, për sa kohë që ruajtja shërben vetëm për ta bërë transmetimin e mëtejshëm të informacionit për marrësit e tjerë të shërbimit, më efikas ose më të sigurtë, me kërkesën e tyre, nëse ofruesi:
 - a) nuk modifikon informacionin;
 - b) përmbush kushtet e aksesit në informacion;
 - c) respekton rregullat për përditësimin e informacionit, të përcaktuara në një mënyrë që njihet dhe përdoret gjerësisht në industri;
 - ç) parandalon përdorimin e paligjshëm të teknologjisë, të njohur dhe të përdorur gjerësisht në industri, me qëllim marrjen e të dhënave mbi përdorimin e informacionit; dhe
 - d) vepron me shpejtësi për të hequr, ose për të çaktivizuar aksesin në informacionin që ka ruajtur sapo merr dijeni se informacioni në burimin fillestar të transmetimit është hequr nga rrjeti, aksesit në të është çaktivizuar, ose gjykata, apo një autoritet kompetent ka urdhëruar heqjen, ose çaktivizimin e aksesit në atë informacion.
2. Ky nen nuk cënon mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm, të kërkojë që ofruesi i shërbimit të ndërpresë, ose të parandalojë një shkelje.

Neni 6

Shërbimi i ruajtjes të informacionit “*Hosting*”

1. Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit, konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesë të marrësit të shërbimit, nëse ofruesi:
 - a) nuk ka dijeni për veprimtarinë e paligjshme ose përmbajtjen e paligjshme dhe sa u përket pretendimeve për dëmshpërblim, nuk është në dijeni të fakteve ose rrethanave nga të cilat rezulton veprimtaria, ose përmbajtja e paligjshme; ose,
 - b) me marrjen dijeni, vepron menjëherë për të hequr ose çaktivizuar aksesin në përmbajtjen e paligjshme.
2. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet kur marrësi i shërbimit vepron në emër ose në kontrollin e ofruesit të shërbimit.
3. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet në lidhje me përgjegjësitë sipas ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, për platformat online që lejojnë konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarët, kur platforma online paraqet informacionin e një produkti specifik, ose në ndonjë mënyrë tjetër lehtëson transaksionin specifik në fjalë, në mënyrë të tillë që e bën një konsumator mesatar të besojë se informacioni, produkti ose shërbimi që është objekt i transaksionit, ofrohet nga vetë platforma online, ose nga një marrës i shërbimit që vepron në emër ose nën kontrollin e saj.
4. Ky nen nuk cënon mundësinë që gjykata ose një autoritet kompetent, në përputhje me legjislacionin kombëtar të zbatueshëm, t'i kërkojë ofruesit të shërbimit të ndërpresë, ose të parandalojë një shkelje.

Neni 7

Investigimet vullnetare me nismën e ofruesit dhe përputhshmëria ligjore

Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, nuk konsiderohen të papërshtatshëm për përjashtimin nga përgjegjësia sipas përcaktimeve në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, vetëm se ata, në mirëbesim dhe në mënyrë të kujdesshme, ndërmarrin vullnetarisht me nismën e tyre, investigimin për përmbajtjet e paligjshme, ose masa të tjera që synojnë zbulimin, identifikimin, heqjen, ose çaktivizimin e aksesit në përmbajtjet e paligjshme, si dhe kur marrin masat e nevojshme për të respektuar kërkesat ligjore në fuqi, përfshirë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 8

Mungesa e detyrimit të përgjithshëm për monitorim

Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse nuk kanë asnjë detyrim të përgjithshëm për monitorimin e informacionit që transmetojnë ose ruajnë, as detyrim për të kërkuar në mënyrë aktive fakte ose rrethana që tregojnë veprimtari të paligjshme.

Neni 9

Urdhrat për të vepruar kundër përmbajtjes së paligjshme

1. Me marrjen e një urdhëri për të vepruar kundër një ose më shumë elementëve specifike të përmbajtjes së paligjshme, të lëshuar nga gjykata ose autoritetet kompetente përkatëse, në bazë të legjislacionit kombëtar të zbatueshëm, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë pa vonesë, autoritetin që lëshon urdhërin, ose çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për çdo efekt të dhënë urdhrit, duke specifikuar nëse dhe, kur ka hyrë në fuqi urdhëri.

2. Urdhëri i përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmbush të paktën kushtet e mëposhtme:
 - a) Urdhri përmban elementet si më poshtë:
 - i. një referencë të bazës ligjore për nxjerrjen e urdhërit sipas ligjit kombëtar;
 - ii. një deklaratë të arsyetuar, që shpjegon pse informacioni është përmbajtje e paligjshme, dhe referencat e një ose më shumë dispozita specifike ligjore sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
 - iii. informacionin që identifikon autoritetin kompetent që ka nxjerrë urdhërin;
 - iv. informacion të qartë, që i mundëson ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse, të identifikojë dhe lokalizojë përmbajtjen e paligjshme në fjalë, një ose më shumë adresa të sakta URL, si dhe kur është e nevojshme informacion shtesë;
 - v. informacion në lidhje me mekanizmat e korrigjimit në dispozicion të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse dhe të marrësit të shërbimit që ka dhënë përmbajtjen;
 - vi. kur është e zbatueshme, informacion për autoritetin i cili informohet për efektin e urdhrave të dhënë;
 - b) fushën territoriale të atij urdhëri, në bazë të rregullave të zbatueshme të së drejtës kombëtare, dhe, kur është e nevojshme, parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, e cila kufizohet rreptësisht për atë sa është e nevojshme për të arritur objektivin e tij;
 - c) urdhëri hartohet në gjuhën shqipe nëse ofruesi është një shoqëri shqiptare dhe kur është një shoqëri e huaj, urdhri i përkthyer në gjuhën angleze i dërgohet pikës së kontaktit online, të përcaktuar nga ofruesi i shërbimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 11, të këtij ligji.
3. Autoriteti që lëshon urdhërin ose, kur është e zbatueshme, autoriteti i specifikuar në të, informon Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale dhe i dërgon urdhërin së bashku me çdo informacion të marrë nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse, në lidhje me efektin e dhënë atij urdhëri.
4. Me qëllim sigurimin e zbatimit të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, i kërkon bashkëpunim Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale, ose autoriteteve të tjera përkatëse të shteteve të tjera.
5. Jo më vonë se, momenti kur urdhërit i jepet efekt ose, sipas rastit, në kohën e parashikuar nga autoriteti lëshues në urdhërin e tij, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë marrësin e shërbimit në fjalë për urdhërin e marrë dhe për efektin që i është dhënë atij. Informacioni për marrësit e shërbimit përfshin një deklaratë të arsyeve, mundësitë për mjetet juridike, që ekzistojnë si dhe një përkthim të fushës territoriale të zbatimit të urdhërit, në përputhje me pikën 2, të këtij neni.
6. Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen, nuk çenojnë zbatimin e dispozitave të së drejtës procedurale civile dhe penale.

Neni 10

Urdhrat për dhënie informacioni

1. Pas marrjes së një urdhëri për të dhënë informacion specifik, për një ose më shumë marrës individualë specifikë të shërbimit, të lëshuar nga autoritetet gjyqësore ose administrative kombëtare përkatëse, në bazë të legjislacionit kombëtar të zbatueshëm, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse duhet, pa vonesë, të informojnë autoritetin që lëshon urdhërin, ose

- çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për marrjen e tij dhe për efektin që i është dhënë urdhërit, duke specifikuar nëse dhe kur iu dha efekt.
2. Urdhëri sipas pikës 1 të këtij neni, që i transmetohet ofruesit, duhet të plotësojë të paktën kushtet e mëposhtme:
- a) urdhëri përmban elementët si më poshtë:
 - i. një referencë të bazës ligjore për urdhërin sipas ligjit kombëtar;
 - ii. informacion që identifikon autoritetin lëshues;
 - iii. informacion të qartë që i mundëson ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse të identifikojë marrësin ose marrësit specifikë të shërbimeve, për të cilët kërkohet informacion, si një ose më shumë emra llogarish ose identifikues unikë;
 - iv. një deklaratë të arsyeve që shpjegon objektivin për të cilin kërkohet informacioni dhe arsyen pse kërkesa për të dhënë informacionin është e nevojshme dhe proporcionale, për të përcaktuar pajtueshmërinë nga marrësit e shërbimeve ndërmjetëse me ligjin kombëtar të zbatueshëm, përveç rastit kur kjo deklaratë nuk mund të jepet për arsye që lidhen me parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale;
 - v. informacion në lidhje me mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion të ofruesit dhe të marrësve të shërbimit në fjalë;
 - vi. aty ku është e zbatueshme, informacion për autoritetin që duhet të marrë informacionin për zbatimin e urdhrave.
 - b) urdhëri kërkon vetëm që ofruesi të japë informacionin e mbledhur për qëllimet e ofrimit të shërbimit dhe që është nën kontrollin e tij;
 - c) urdhëri përpilohet në gjuhën shqipe, nëse ofruesi është një shoqëri shqiptare, me një përkthim në gjuhën angleze nëse ofruesi është një shoqëri e huaj dhe i dërgohet pikës elektronike të kontaktit të caktuar nga ai ofrues, në përputhje me nenin 11, të këtij ligji.
3. Autoriteti lëshues i urdhrit ose, sipas rastit, autoriteti i përcaktuar në të, ia transmeton atë, së bashku me çdo informacion të marrë nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse në lidhje me efektin e dhënë atij urdhri, Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.
4. Me qëllim sigurimin e zbatimit të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, kërkon bashkëpunimin e Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale, ose autoriteteve të tjera përkatëse nga shtetet e tjera.
5. Jo më vonë se momenti i zbatimit të urdhrit ose, sipas rastit, në kohën e parashikuar nga autoriteti lëshues në urdhrin e tij, ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë marrësin e shërbimit përkatës për urdhrin e marrë dhe efektin që i është dhënë atij. Informacioni për marrësin e shërbimit përfshin një deklaram të arsyeve dhe mundësitë për dëmshpërblim që ekzistojnë, në përputhje me pikën 2, të këtij neni.
6. Kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë nen, nuk çenojnë kërkesat e së drejtës procedurale civile dhe penale.

KREU III

DETYRIMET E KUJDESIT TË DUHUR PËR NJË MJEDIS ONLINE

TRANSPARENT DHE TË SIGURT

SEKSIONI 1

DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR TË GJITHË OFRUESIT E SHËRBIMEVE NDËRMJETËSE

Neni 11

Caktimi i pikave të kontaktit për autoritetet

1. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse caktojnë një pikë të vetme kontakti, për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me mjete elektronike, me autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë.
2. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse publikojnë informacionin e nevojshëm për të identifikuar lehtësisht dhe për të komunikuar me pikat e tyre të vetme të kontaktit. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe i përditësuar.
3. Autoritetet kompetente dhe ato gjyqësore komunikojnë me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse në gjuhën shqipe, nëse ofruesi është një shoqëri shqiptare dhe në gjuhën angleze nëse është një shoqëri e huaj.

Neni 12

Pikat e kontaktit për marrësit e shërbimit

1. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse caktojnë një pikë të vetme kontakti, për t'u mundësuar marrësve të shërbimit, të komunikojnë drejtpërdrejt dhe me shpejtësi me ta. Komunikimi bëhet nëpërmjet mjeteve elektronike dhe në mënyrë të lehtë për përdoruesin, përfshirë mundësinë që marrësit e shërbimit të zgjedhin mjetet e komunikimit, që nuk mbështeten vetëm në mjete të automatizuara.
2. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse bëjnë publik informacionin e nevojshëm për marrësit e shërbimit, në mënyrë që të identifikojnë lehtësisht dhe të komunikojnë me pikat e tyre të vetme të kontaktit. Informacioni i publikuar është lehtësisht i aksesueshëm dhe i përditësuar.

Neni 13

Përfaqësuesi ligjor

1. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që nuk kanë një seli në Republikën e Shqipërisë, por që ofrojnë shërbime në Republikën e Shqipërisë, caktojnë me shkrim, një person juridik ose fizik që vepron si përfaqësuesi i tyre ligjor për Republikën e Shqipërisë. Për qëllimet e këtij ligji, përfaqësuesi ligjor për Republikën e Shqipërisë mund të jetë i vendosur në Shqipëri, ose në një shtet anëtar të Bashkimit Europian.
Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse autorizojnë përfaqësuesit e tyre ligjorë, me qëllim që, për të gjitha çështjet e nevojshme për marrjen, respektimin dhe zbatimin e vendimeve të nxjerra në lidhje me këtë ligj, nga autoritetet administrative ose gjyqësore kompetente dhe Koordinatori i Shërbimeve Digjitale i Republikës së Shqipërisë, t'u drejtohen atyre përveç ofruesit ose në vend të ofruesit. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse pajisin përfaqësuesit e tyre ligjorë me kompetencat e nevojshme dhe burime të mjaftueshme për të garantuar bashkëpunimin efikas dhe në kohë me autoritetet gjyqësore, autoritetet administrative kompetente dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale të Republikës së Shqipërisë, si dhe për të respektuar këto vendime.

3. Përfaqësuesi ligjor i caktuar është përgjegjës për mosrespektimin e detyrimeve sipas këtij ligji, pa cënuar përgjegjësinë dhe veprimet ligjore që mund të iniciohen kundër ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse.
4. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse njoftojnë Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale në Republikën e Shqipërisë për emrin, adresën postare, adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të tyre ligjor.
5. Caktimi i një përfaqësuesi ligjor në përputhje me pikën 1, të këtij neni nuk përbën themelimi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Kushtet dhe afatet

1. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse në termat dhe kushtet e tyre për ofrimin e shërbimeve, përfshijnë informacion mbi çdo kufizim që ata vendosin në lidhje me përdorimin e shërbimit të tyre për sa i përket informacionit të ofruar nga marrësit e shërbimit. Ky informacion përfshin informacion mbi çdo politikë, procedurë, masë dhe mjet të përdorur për qëllimin e moderimit të përmbajtjes, përfshirë vendimmarrjen algoritmike dhe shqyrtimin njerëzor, si dhe rregullat e procedurës të sistemit të tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave. Informacioni paraqitet në gjuhë të qartë, të thjeshtë, të kuptueshme, miqësore për përdoruesin dhe pa ekuivoke. Ky informacion publikohet në një format lehtësisht të aksesueshëm dhe të lexueshëm nga pajisjet.
2. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse informojnë marrësit e shërbimit për çdo ndryshim të rëndësishëm të kushteve dhe afateve.
3. Kur një shërbim ndërmjetës u drejtohet kryesisht të miturve, ose përdoret kryesisht prej tyre, ofruesi i shërbimit ndërmjetës shpjegon kushtet për përdorimin e shërbimit, si dhe çdo kufizim mbi to, në një mënyrë të kuptueshme për të miturit.
4. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, në zbatimin dhe ekzekutimin e kufizimeve të përmendura në pikën 1, të këtij neni, veprojnë në mënyrë të kujdesshme, objektive dhe proporcionale, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të përfshira, përfshirë të drejtat themelore të marrësve të shërbimit, si liria e shprehjes, liria dhe pluralizmi i medias, si dhe të drejta dhe liri të tjera themelore, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
5. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, u ofrojnë marrësve të shërbimeve një përmbledhje koncize, lehtësisht të aksesueshme dhe të lexueshme nga pajisjet të kushteve dhe termave, përfshirë mjetet e disponueshme të ankimimit dhe mekanizmat e zhdëmtimit, në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme.
6. Platformat shumë të mëdha online dhe motorët e kërkimit online shumë të mëdhenj, sipas nenit 33, të këtij ligji, publikojnë kushtet dhe afatet e tyre në gjuhët zyrtare të të gjitha Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, ku ato ofrojnë shërbimet e tyre.

Neni 15

Detyrimet e raportimit të transparencës për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse

1. Ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse vënë në dispozicion të publikut, në një format të lexueshëm nga pajisjet dhe në një mënyrë lehtësisht të aksesueshme, të paktën një herë në

vit, raporte të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme mbi çdo shqyrtim përmbajtjeje ku ata janë angazhuar gjatë periudhës përkatëse. Këto raporte sipas rastit përfshijnë, në veçanti, informacion mbi sa vijon:

- a) për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, numrin e urdhrave të marra nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë urdhrat e nxjerra në përputhje me nenet 9 dhe 10, të këtij ligji, të kategorizuara sipas llojit të përmbajtjes së paligjshme në fjalë, autoritetit që nxjerr urdhërin, dhe kohën mesatare të nevojshme për të njoftuar autoritetin që nxjerr urdhërin, ose çdo autoritet tjetër të përcaktuar në urdhër, për marrjen dhe zbatimin e tij;
 - b) për ofruesit e shërbimeve të hostimit, numrin e njoftimeve të paraqitura në përputhje me nenin 16, të këtij ligji, të kategorizuara sipas llojit të përmbajtjes së pretenduar të paligjshme, numrin e njoftimeve të paraqitura nga sinjalizues të besuar, çdo veprim të ndërmarrë në bazë të njoftimeve, duke dalluar nëse veprimi është ndërmarrë në bazë të ligjit, ose të termave dhe kushteve të ofruesit, numrin e njoftimeve të përpunuara, duke përdorur mjete të automatizuara dhe kohën mesatare të nevojshme për ndërmarrjen e veprimit;
 - c) për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, informacion të plotë dhe të kuptueshëm për shqyrtimin e përmbajtjes, të kryer me nismën e ofruesit, përfshirë përdorimin e mjeteve të automatizuara, masat e marra për të ofruar trajnime dhe ndihmë për personat përgjegjës për shqyrtimin e përmbajtjes, numrin dhe llojin e masave të marra që ndikojnë në disponueshmërinë, dukshmërinë dhe aksesueshmërinë e informacionit të ofruar nga marrësit e shërbimit dhe aftësinë e marrësve për të ofruar informacion nëpërmjet shërbimit dhe kufizime të tjera të lidhura të shërbimit. Informacioni i raportuar kategorizohet sipas llojit të përmbajtjes së paligjshme, ose shkëljes së termave dhe kushteve të ofruesit të shërbimit, sipas metodës së zbulimit dhe sipas llojit të kufizimit të zbatuar;
 - d) për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse, numrin e ankesave të marra nëpërmjet sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave, në përputhje me kushtet dhe afatet e ofruesit dhe përveç kësaj, për ofruesit e platformave online, në përputhje me nenin 20, të këtij ligji, bazën për ankesat, vendimet e marra në lidhje me to, kohën mesatare të nevojshme për marrjen e vendimeve dhe numrin e rasteve kur ka pasur ndryshime të vendimeve;
 - e) çdo përdorim të mjeteve të automatizuara për qëllimin e shqyrtimit të përmbajtjes, duke përfshirë një përshkrim cilësor, një specifikim të qëllimeve të sakta, tregues të saktësisë dhe shkallës së mundshme të gabimit të mjeteve të automatizuara të përdorura në përmbushjen e këtyre qëllimeve dhe çdo masë mbrojtëse të zbatuar.
2. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet për ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që kualifikohen si ndërmarrje të vogla dhe mikrondërmarrje, sipas ligjit nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.
 3. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, miraton aktet zbatuese mbi përcaktimin e modeleve lidhur me formën, përmbajtjen dhe hollësi të tjera të raporteve në përputhje me pikën 1, të këtij neni, përfshirë dhe periudhat e raportimit të harmonizuar me praktikën e miratuar nga Komisioni Evropian.

SEKSIONI 2

DISPOZITA SHITESË TË ZBATUESHME PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË HOSTIMIT, PËRFSHIRË PLATFORMAT ONLINE

Neni 16

Mekanizmat e njoftimit dhe veprimit

1. Ofruesit e shërbimeve të hostimit, vendosin mekanizma për të lejuar çdo individ ose subjekt t'i njoftojë ofruesit mbi praninë në shërbimin e tyre, të elementeve specifike të informacionit që individit ose subjekti, i konsideron përmbajtje të paligjshme. Këto mekanizma janë lehtësisht të aksesueshëm dhe të lehtë për përdoruesin dhe lejojnë paraqitjen e njoftimeve ekskluzivisht me mjete elektronike.
2. Mekanizmat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, lehtësojnë paraqitjen e njoftimeve mjaftueshëm të sakta dhe të mirëargumentuara. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të hostimit marrin masat e nevojshme për të mundësuar dhe për të lehtësuar paraqitjen e njoftimeve që përmbajnë të gjithë elementët e mëposhtëm:
 - a) një shpjegim të mirëargumentuar të arsyeve pse individit ose subjekti pretendon se informacioni në fjalë është përmbajtje e paligjshme;
 - b) një paraqitje të qartë të vendndodhjes së saktë elektronike të atij informacioni, si URL-ja e saktë ose disa URL të sakta dhe kur është e nevojshme, informacione shtesë që mundësojnë identifikimin e përmbajtjes së paligjshme të përshtatura sipas llojit të përmbajtjes dhe llojit specifik të shërbimit të hostimit;
 - c) emrin dhe adresën postës elektronike të individit ose entitetit që paraqet njoftimin, përveç në rastin e informacionit që konsiderohet se përfshin një nga veprat penale të përmendura në nenet 3, deri në 7, të Direktivës 2011/93/EU, si një vepër penale që lidhet me abuzimin seksual të të miturve, shfrytëzimin seksual të të miturve, pornografinë e fëmijëve, joshjen e të miturve për qëllime seksuale ose vepra të tjera penale me përmbajtje të ngjashme, si dhe nxitjen, ndihmën, bashkëpunimin dhe tentativën për të kryer veprat penale të sipërpërmendura;
 - d) një deklaratë që konfirmon besimin e sinqertë të individit, ose entitetit që paraqet njoftimin, se informacioni dhe pretendimet e përfshira në të, janë të sakta dhe të plota.
3. Njoftimet e cituara në këtë nen, konsiderohen se sjellin njohuri ose ndërgjegjësim faktik për qëllimet e nenit 6, të këtij ligji, në lidhje me elementin specifik të informacionit në fjalë, kur ato i lejojnë një ofruesi të kujdesshëm të shërbimeve të hostimit të identifikojë paligjshmërinë e veprimtarisë, ose informacionit përkatës, pa një shqyrtim të hollësishëm ligjor.
4. Kur njoftimi përmban informacionin elektronik të kontaktit të individit, ose entitetit që e ka paraqitur atë, ofruesi i shërbimeve të hostimit i dërgon menjëherë, individit ose entitetit të interesuar, një konfirmim për marrjen e njoftimit.
5. Ofruesi gjithashtu, njofton menjëherë individin ose entitetin për vendimin e tij, për informacionin me të cilin lidhet njoftimi, duke dhënë informacion mbi mundësitë për mjete juridike për vendimin.
6. Ofruesit e shërbimeve të hostimit përpunojnë çdo njoftim që marrin sipas mekanizmave të përmendur në pikën 1, të këtij neni dhe marrin vendimet e tyre për informacionin me të cilin lidhen njoftimet, në një mënyrë koherente, të kujdesshme, jo arbitrare dhe objektive. Kur ata përdorin mjete të automatizuara për përpunimin ose vendimmarrjen, përfshijnë informacion për një përdorim të tillë në njoftimin e përmendur në pikën 5, të këtij neni.

Neni 17

Deklarata e arsyeve

1. Ofruesit e shërbimeve të hostimit, ofrojnë një deklaratë të qartë dhe specifike të arsyeve për çdo marrës shërbimi të prekur, nga secili prej kufizimeve të mëposhtme, të vendosur mbi arsyetimin që informacioni i ofruar nga marrësi i shërbimit, përbën përmbajtje të paligjshme, ose është i papajtueshëm me termat dhe kushtet e tyre:
 - a) çdo kufizim mbi dukshmërinë e elementeve specifike të informacionit të ofruar nga marrësi i shërbimit, përfshirë heqjen e përmbajtjes, çaktivizimin e aksesit në përmbajtje, ose reduktimin e caktimit të prioriteteve të përmbajtjes;
 - b) pezullimin, ndërprerjen ose kufizime të tjera të pagesave monetare;
 - c) pezullimin ose ndërprerjen tërësisht ose pjesërisht, të ofrimit të shërbimit;
 - ç) pezullimin ose mbylljen e llogarisë së marrësit të shërbimit.
2. Pika 1, e këtij neni, zbatohet vetëm në rastet kur të dhënat përkatëse elektronike të kontaktit, janë të njohura për ofruesin, dhe jo më vonë se data në të cilën vendoset kufizimi, pavarësisht nga arsyeja ose mënyra e vendosjes së tij. Pika 1, e këtij neni, nuk zbatohet kur informacioni përbën një përmbajtje tregtare mashtruese me shtrirje të gjërë.
3. Deklarata e arsyeve e përmendur në pikën 1, të këtij neni, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) informacion nëse vendimi sjell heqjen, çaktivizimin e aksesit, uljen e renditjes ose kufizimin e dukshmërisë së informacionit, ose pezullimin apo ndërprerjen e pagesave monetare të lidhura me atë informacion, ose vendos masa të tjera të përmendura në pikën 1, të këtij neni, në lidhje me informacionin, si dhe, kur është e aplikueshme, shtrirjen territoriale të vendimit dhe kohëzgjatjen e tij;
 - b) faktet dhe rrethanat mbi të cilat është mbështetur marrja e vendimit, përfshirë, kur është e aplikueshme, informacion nëse vendimi është marrë në bazë të një njoftimi të paraqitur në përputhje me nenin 16, të këtij ligji, ose mbi bazën e investigimeve vullnetare, si dhe, kur është rreptësisht e nevojshme, identitetin e njoftuesit;
 - c) sipas rastit, informacion mbi përdorimin e mjeteve të automatizuara në marrjen e vendimit, përfshirë informacion nëse vendimi është marrë në lidhje me përmbajtjen evidente ose identifikuar nëpërmjet mjeteve të automatizuara;
 - ç) referimin ndaj bazës ligjore mbi të cilën është mbështetur vendimi, kur vendimi lidhet me përmbajtje të pretenduar si të paligjshme, si dhe shpjegime mbi arsyet pse informacioni konsiderohet përmbajtje e paligjshme mbi atë bazë;
 - d) referimin ndaj bazës kontraktore mbi të cilën është mbështetur vendimi, si dhe shpjegime mbi arsyet pse informacioni konsiderohet i papajtueshëm me atë bazë, kur vendimi bazohet në papajtueshmërinë e pretenduar të informacionit me termat dhe kushtet e ofruesit të shërbimeve të hostimit;
 - dh) informacion të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm për përdoruesin mbi mundësitë e ankimit ose të mjeteve të mbrojtjes juridike në dispozicion të marrësit të shërbimit, në lidhje me vendimin, veçanërisht, kur është e aplikueshme, nëpërmjet mekanizmave të brendshëm të trajtimit të ankesave, zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe mjeteve gjyqësore të mbrojtjes.

4. Informacioni i dhënë nga ofruesit e shërbimeve të hostimit në përputhje me këtë nen, duhet të jetë i qartë, lehtësisht i kuptueshëm dhe sa më i saktë dhe specifik që të jetë e arsyeshme, sipas rrethanave konkrete. Në veçanti, informacioni i mundëson në mënyrë të arsyeshme marrësit të prekur të shërbimit, të ushtrojë në mënyrë efektive mundësitë e ankimit, ose të mbrojtjes juridike të përmendura në gjurmën f, të pikës 3, të këtij neni.
5. Ky nen nuk zbatohet për urdhrat e përmendur në nenin 9, të këtij ligji.

Neni 18

Njoftimi mbi dyshimet për vepra penale

1. Kur një ofrues i shërbimeve të hostimit, merr dijeni për çdo informacion që ngre dyshime se një vepër penale, e cila përfshin kërcënim ndaj jetës ose sigurisë së një ose më shumë personave, është kryer, është duke u kryer, ose ka gjasa të kryhet, ai njofton menjëherë autoritetet ligjzbatuese ose autoritetet gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.
2. Kur ofruesi i shërbimeve të hostimit, nuk mund të përcaktojë me siguri të arsyeshme, nëse vepra penale është kryer brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por ka dyshime të arsyeshme lidhur me këtë, ai njofton autoritetin kompetent, autoritetin gjyqësor dhe Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale të Republikës së Shqipërisë.

SEKSIONI 3

DISPOZITA SHITESË TË ZBATUESHME PËR OFRUESIT E PLATFORMAVE ONLINE

Neni 19

Përfshirjet për ndërmarrjet mikro dhe të vogla

1. Me përfshirje të pikës 3, të nenit 24, të këtij ligji, ky seksion nuk zbatohet:
 - a) për ofruesit e platformave online që klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe mikrondërmarrje, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, si dhe,
 - b) për ofruesit e platformave online që më parë kualifikoheshin në statusin e një ndërmarrje të vogël dhe mikrondërmarrje, gjatë 12 muajve pas humbjes së atij statusi, përveçse kur ato janë platforma online shumë të mëdha në përputhje me nenin 33, të këtij ligji.
2. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, ky seksion do të zbatohet për ofruesit e platformave online që janë përcaktuar si platforma online shumë të mëdha në përputhje me nenin 33, të këtij ligji pavarësisht nëse kualifikohen si ndërmarrje të vogël dhe mikrondërmarrje.

Neni 20

Sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave

1. Ofruesit e platformave online, u sigurojnë marrësve të shërbimit, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur një njoftim, për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh nga marrja e vendimit të përmendur në këtë pikë, akses në një sistem efektiv të brendshëm të

trajtimin të ankesave, i cili u mundëson atyre të paraqesin ankesa në mënyrë elektronike dhe pa pagesë, kundër vendimit të marrë nga ofruesi i platformës online pas marrjes së një njoftimi, ose kundër vendimeve të mëposhtme të marra nga ofruesi i platformës online, mbi bazën se informacioni i ofruar nga marrësit e shërbimit përbën përmbajtje të paligjshme, ose është i papajtueshëm me termat dhe kushtet e tij:

- a) vendimet nëse hiqet, çaktivizohet aksesimi ose kufizohet paraqitja e informacionit;
 - b) vendimet nëse pezullohet, ose ndërpritet ofrimi i shërbimit tërësisht ose pjesërisht, për marrësit e shërbimit;
 - c) vendimet nëse pezullohet, ose mbyllet llogaria e marrësve të shërbimit;
 - ç) vendimet nëse pezullohet, ndërpritet, ose kufizohet ndryshe aftësia për të gjeneruar të ardhura nga informacioni i ofruar nga marrësit e shërbimit.
2. Periudha prej të paktën gjashtë muajsh e përmendur në pikën 1, të këtij neni, fillon në ditën në të cilën marrësi i shërbimit njoftohet për vendimin në përputhje me pikën 5, të nenit 16, të këtij ligji, ose me nenin 17, të këtij ligji.
 3. Ofruesit e platformave online, sigurojnë që sistemet e tyre të brendshme të trajtimit të ankesave, të jenë lehtësisht të aksesueshme, miqësore për përdoruesin dhe të mundësojnë e lehtësojnë paraqitjen e ankesave mjaftueshmërisht të sakta dhe të argumentuara në mënyrë të përshtatshme.
 4. Ofruesit e platformave online i trajtojnë ankesat e paraqitura përmes sistemit të tyre të brendshëm të trajtimit të ankesave, në mënyrë të shpejtë, jo-diskriminuese, të kujdesshme dhe jorabitrare. Kur një ankesë përmban arsye të mjaftueshme për ofruesin e platformës online për të konsideruar se vendimi i tij për të mos vepruar mbi bazën e njoftimit është i pabazuar, ose se informacioni përkatës nuk përbën përmbajtje të paligjshme dhe nuk është i papajtueshëm me termat dhe kushtet e tij, ose përmban informacion që tregon se sjellja e ankuesit nuk justifikon masën e marrë, ai e ndryshon menjëherë vendimin e tij të përmendur në pikën 1, të këtij neni.
 5. Ofruesit e platformave online, i informojnë ankuesit menjëherë për vendimin e tyre të arsyetuar, në lidhje me informacionin që është objekt i ankesës, si dhe për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore të parashikuar në nenin 21, të këtij ligji dhe për mundësitë e tjera të disponueshme të mbrojtjes juridike.
 6. Ofruesit e platformave online, sigurojnë që vendimet e përmendura në pikën 5, të këtij neni, të merren nën mbikëqyrjen e personelit të kualifikuar dhe jo vetëm mbi bazën e mjeteve të automatizuara.

Neni 21

Zgjidhja jashtëgjyqësore e mosmarrëveshjeve

1. Marrësit e shërbimit, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur njoftime, që preken nga vendimet e përmendura në pikën 1, të nenit 20, të këtij ligji, kanë të drejtë të zgjedhin çdo organ të certifikuar për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, në përputhje me pikën 3, të këtij neni, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me ato vendime, përfshirë ankesat që nuk janë zgjidhur përmes sistemit të brendshëm të trajtimit të ankesave të përmendur në atë nen.
2. Ofruesit e platformave online, sigurojnë që informacioni mbi mundësinë për zgjidhje jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, të jetë lehtësisht i aksesueshëm në ndërfaqen e tyre online, i qartë dhe miqësor për përdoruesin. Pika 1, e këtij neni, nuk cënon të drejtën e marrësit të shërbimit për të iniciuar, në çdo fazë një proces gjyqësor për kundërshtimin e këtyre vendimeve të ofruesve të platformave online, në përputhje me ligjin e zbatueshëm.
3. Të dyja palët angazhohen me mirëbesim, në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes pranë organit të certifikuar të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, me qëllim zgjidhjen e saj. Ofruesit e platformave online, refuzojnë të angazhohen me një organ të

tillë, nëse një mosmarrëveshje e mëparshme është zgjidhur tashmë në lidhje me të njëjtin informacion dhe të njëjtat baza të pretenduara të paligjshmërisë ose papajtueshmërisë së përmbajtjes. Organi i certifikuar për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, nuk ka të drejtë të imponojë një zgjidhje të detyrueshme të mosmarrëveshjes mbi palët.

4. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale certifikon organin/et për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, e cila mund të rinovohet, me kërkesën e tij, kur ai ka provuar se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) është i paanshëm dhe i pavarur edhe financiarisht, nga ofruesit e platformave online dhe nga marrësit e shërbimit të ofruar nga ofruesit e platformave online, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur njoftime;
 - b) ka ekspertizën e nevojshme në lidhje me çështjet që lindin në një ose më shumë fusha të veçanta të përmbajtjes së paligjshme, ose në lidhje me zbatimin dhe ekzekutimin e termave dhe kushteve të një ose më shumë llojeve të platformave online, duke i mundësuar organit të kontribuojë në mënyrë efektive në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 - c) anëtarët e tij shpërblehen në një mënyrë që nuk lidhet me rezultatin e procedurës/vendimit të marrë;
 - ç) zgjidhja jashtëgjyqësore e mosmarrëveshjeve që ofrohet, është lehtësisht e aksesueshme, përmes teknologjive të komunikimit elektronik dhe mundëson fillimin e procedurës dhe dorëzimin e dokumenteve mbështetëse përkatëse online;
 - d) është në gjendje të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë të shpejtë, efikase dhe me kosto të ulët;
 - e) zgjidhja jashtëgjyqësore e mosmarrëveshjeve zhvillohet në përputhje me rregulla të qarta dhe të drejta procedurale, që janë lehtësisht të aksesueshme dhe publike dhe që janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, përfshirë këtë nen.
5. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, kur është e aplikueshme, specifikon në certifikatë:
 - a) çështjet e veçanta për të cilat lidhet ekspertiza e organit, siç parashikohet në shkronjën b, të pikës 4, të këtij neni.
 - b) gjuha e procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes, është gjuha shqipe.
6. Organet e certifikuara për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, i raportojnë çdo vit Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale që i ka certifikuar, mbi funksionimin e tyre, duke specifikuar të paktën numrin e mosmarrëveshjeve të pranuara, informacion mbi rezultatet e zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve, kohën mesatare të zgjidhjes dhe çdo mangësi ose vështirësi të hasur. Ata japin informacion shtesë me kërkesë të Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.
7. Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale, çdo dy vjet, hartojnë një raport mbi funksionimin e organeve të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve që kanë certifikuar. Ky raport në veçanti:
 - a) liston numrin e mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore që çdo organ i certifikuar ka pranuar çdo vit;
 - b) tregon rezultatet e procedurave dhe kohën mesatare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtëgjyqësore;
 - c) identifikon dhe shpjegon çdo mangësi sistematike ose sektoriale në funksionim;
 - d) identifikon praktikatat më të mira;
 - e) bën rekomandime për përmirësimin e funksionimit, kur është e përshtatshme.
8. Organet e certifikuara për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, bëjnë të disponueshme vendimet e tyre për palët brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 90 ditë kalendarike nga marrja e ankesës. Në rast mosmarrëveshjes veçanërisht komplekse, ky afat mund të zgjatet edhe për 90 ditë të tjera kalendarike, duke mos tejkaluar në total 180 ditë.
9. Nëse organi i zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, vendos në favor të marrësit të shërbimit, përfshirë individin ose subjektin që ka paraqitur njoftim, ofruesi i platformës online përballon të gjitha tarifat e organit dhe rimbursos marrësin, përfshirë individin ose

subjektin, për çdo shpenzim tjetër të arsyeshëm, të bërë në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

10. Nëse organi vendos në favor të ofruesit të platformës online, marrësi i shërbimit, përfshirë individin ose subjektin, nuk detyrohet të rimbursojë asnjë tarifë, ose shpenzim tjetër të paguar, ose që duhet të paguhet nga ofruesi i platformës online, përveç rastit kur organi konstaton se marrësi ka vepruar me keqbesim në mënyrë të dukshme.
11. Tarifat e ngarkuara nga organi i zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve ndaj ofruesve të platformave online, janë të arsyeshme dhe në çdo rast nuk tejkalojnë kostot e bëra nga organi. Për marrësit e shërbimit, zgjidhja është pa pagesë, ose me një tarifë të vogël për mbulimin e kostove (*nominale*).
12. Organet e certifikuara për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, bëjnë të njohura tarifat ose mekanizmat e përcaktimit të tyre për marrësit e shërbimit, përfshirë individët ose subjektet që kanë paraqitur njoftim, si dhe për ofruesin e platformës online, përpara fillimit të procedurës.
13. Organet e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve të krijohen për qëllimet e pikës 1, të këtij neni, ose të mbështesin aktivitetet e disa ose të gjitha organeve që kanë certifikuar, në përputhje me pikën 4, të këtij neni.
14. Koordinator i Shërbimeve Digjitale që ka certifikuar një organ të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, revokon certifikimin nëse pas një hetimi me iniciativën e tij ose mbi bazën e informacionit të marrë nga palë të treta, konstaton, se organi i zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara në pikën 3, të këtij neni. Përpara revokimit të certifikatës, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, i jep mundësi organit të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, të paraqesë qëndrimin e tij mbi gjetjet dhe synimin për revokim.
15. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, publikon në faqen e tij online, listën e organeve të certifikuara të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve dhe atyre të cilave u është revokuar certifikimi.

Neni 22

Sinjalizuesit e besuar

1. Ofruesit e platformave online, marrin masat e nevojshme teknike dhe organizative për të siguruar që njoftimet e paraqitura nga sinjalizuesit e besuar, që veprojnë brenda fushës së tyre të caktuar të ekspertizës, përmes mekanizmave të përmendur në nenin 16 të këtij ligji, të trajtohen me përparësi dhe të shqyrtohen e të merret vendim për to në mënyrë të menjëhershme.
2. Statusi i “sinjalizuesit të besuar” sipas këtij ligji, jepet me kërkesë të çdo subjekti, nga Koordinator i Shërbimeve Digjitale, për aplikuesin që ka provuar se plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) ka ekspertizë dhe kompetencë të veçantë për qëllimet e zbulimit, identifikimit dhe njoftimit të përmbajtjes së paligjshme;
 - b) është i pavarur nga çdo ofrues i platformave online;
 - c) kryen veprimtarinë e tij për qëllime të paraqitjes së njoftimeve në mënyrë të kujdesshme, të saktë dhe objektive.
3. Sinjalizuesit e besuar publikojnë, të paktën një herë në vit, raporte të qarta, të kuptueshme dhe të detajuara mbi njoftimet e paraqitura në përputhje me nenin 16 të këtij ligji, gjatë periudhës përkatëse. Raporti përfshin të paktën numrin e njoftimeve të kategorizuara sipas:
 - a) identitetit të ofruesit të shërbimeve të hostimit;
 - b) llojit të përmbajtjes së pretenduar që është njoftuar si e paligjshme;
 - c) masës së marrë nga ofruesi.
4. Këto raporte përfshijnë një shpjegim të procedurave të vendosura për të siguruar që sinjalizuesi i besuar ruan pavarësinë e tij. Sinjalizuesit e besuar ia dërgojnë këto raporte

- Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, që ka dhënë statusin dhe i bëjnë ato të disponueshme për publikun. Informacioni në këto raporte nuk përmban të dhëna personale.
5. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale publikon në faqen e tij të internetit, emrat, adresat dhe adresat e postës elektronike për entitetet të cilave ju është dhënë statusi i sinjalizuesit të besuar në përputhje me pikën 2, të këtij neni, si dhe ato sinjalizues të besuar statusi i të cilëve është pezulluar në përputhje me pikën 6 ose është revokuar sipas pikës 7 të këtij neni. Lista e publikuar nga Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, i dërgohet Komisionit Evropian për qëllime shkëmbimi informacioni dhe koordinimi.
 6. Kur një ofrues i platformave online ka informacion që tregon se një sinjalizues i besuar ka paraqitur një numër të konsiderueshëm njoftimesh të pasakta, pamjaftueshmërisht të sakta ose të pambështetura në mënyrë të mjaftueshme përmes mekanizmave të përmendur në nenin 16, të këtij ligji, përfshirë informacionin e mbledhur në lidhje me trajtimin e ankesave përmes sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave të përmendura në pikën 4, të nenit 20, të këtij ligji, ai ia komunikon këtë informacion Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale që ka dhënë statusin e sinjalizuesit të besuar subjektit përkatës, duke dhënë shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të nevojshme. Pas marrjes së informacionit nga ofruesi i platformës online dhe nëse Koordinatori i Shërbimeve Digjitale vlerëson se ekzistojnë arsye të ligjshme për të hapur një hetim, ndërmerr menjëherë procesin e hetimit. Gjatë periudhës së hetimit, statusi i sinjalizuesit të besuar pezullohet.
 7. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale që ka dhënë statusin e sinjalizuesit të besuar një subjekti, revokon këtë status nëse konstaton, pas një hetimi të kryer me iniciativën e vet ose mbi bazën e informacionit të marrë nga palë të treta, përfshirë informacionin e dhënë nga një ofrues i platformave online në përputhje me pikën 6, të këtij neni, se subjekti nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni. Përpara revokimit të këtij statusi, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale i jep subjektit mundësinë të reagojë ndaj gjetjeve të hetimit dhe ndaj synimit për revokimin e statusit të tij si sinjalizues i besuar.
 8. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, për të ndihmuar ofruesit e platformave online në zbatimin e pikave 2, 5, 6 dhe 7, të këtij neni, ka të drejtë të nxjerrë udhëzime të bazuara në udhëzimet përkatëse të Komisionit Evropian.

Neni 23

Masat dhe mbrojtja kundër abuzimit

1. Ofruesit e platformave online, pas dhënies së një paralajmërimi paraprak, pezullojnë për një periudhë të arsyeshme kohe ofrimin e shërbimeve të tyre për marrësit e shërbimit, që paraqesin në mënyrë të përsëritur përmbajtje qartësisht të paligjshme.
2. Ofruesit e platformave online pas dhënies së një paralajmërimi paraprak, pezullojnë për një periudhë të arsyeshme kohe, përpunimin e njoftimeve dhe ankesave të paraqitura përmes mekanizmave të njoftimit dhe veprimit si dhe sistemeve të brendshme të trajtimit të ankesave, të përmendura në nenin 16 dhe 20, të këtij ligji, respektivisht nga individë, subjekte apo ankues, që në mënyrë të përsëritur paraqesin njoftime ose ankesa qartësisht të pabazuara.
3. Kur vendosin për pezullimin, ofruesit e platformave online vlerësojnë, rast pas rasti dhe në mënyrë të shpejtë, të kujdesshme dhe objektive, nëse marrësi i shërbimit, individi, subjekti ose ankuesi kryen abuzimin e përmendur në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse që rezultojnë nga informacioni i disponueshëm për ofruesin e platformës online. Këto rrethana përfshijnë të paktën:

- a) numrin absolut të rasteve të përmbajtjes qartësisht të paligjshme, të njoftimeve apo ankesave qartësisht të pabazuara, të paraqitura brenda një periudhe të caktuar kohore;
 - b) përqindjen relative të tyre në raport me numrin total të elementeve të informacionit të ofruar ose njoftimeve të paraqitura brenda së njëjtës periudhë;
 - c) peshën e abuzimeve, përfshirë natyrën e përmbajtjes së paligjshme dhe pasojat e saj;
 - d) kur është e mundur të identifikohet, qëllimin e marrësit të shërbimit, individit, subjektit ose ankuesit.
4. Ofruesit e platformave online përcaktojnë, në mënyrë të qartë dhe të detajuar, në termat dhe kushtet e tyre, politikën në lidhje me abuzimin e përmendur në pikat 1 dhe 2, të këtij neni dhe japin shembuj të fakteve dhe rrethanave që marrin parasysh, kur vlerësojnë nëse një sjellje e caktuar përbën abuzim, si dhe kohëzgjatjen e pezullimit.

Neni 24

Raportimi i transparencës për platformat online

1. Përveç informacionit të përmendur në nenin 15, të këtij ligji, ofruesit e platformave online përfshijnë në raportet e parashikuara në atë nen edhe informacion mbi sa vijon:
 - a) numrin e mosmarrëveshjeve të paraqitura pranë organeve të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve të përmendura në nenin 21, të këtij ligji, rezultatet e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, kohën mesatare të nevojshme për përfundimin e procedurave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, si dhe përqindjen e rasteve në të cilat ofruesi i platformës online ka zbatuar vendimet e organit;
 - b) numrin e pezullimeve të vendosura në përputhje me nenin 23, të këtij ligji, duke bërë dallim midis pezullimeve të vendosura për ofrimin e përmbajtjes qartësisht të paligjshme, paraqitjen e njoftimeve qartësisht të pabazuara dhe paraqitjen e ankesave qartësisht të pabazuara.
2. Të paktën një herë në çdo gjashtë muaj, ofruesit publikojnë për çdo platformë online ose motor kërkimi online, në një seksion publikisht të aksesueshëm të ndërfaqes së tyre online, informacion mbi numrin mesatar të përfituesve aktivë mujorë të shërbimit në Republikën e Shqipërisë, të llogaritur si mesatare gjatë periudhës së gjashtë muajve të fundit dhe në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në përputhje me aktet e deleguara të përmendura në pikën 3, të nenit 33, të këtij ligji.
3. Ofruesit e platformave online ose të motorëve të kërkimit online, i komunikojnë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, me kërkesë të tij dhe pa vonesë, informacionin e përmendur në pikën 2, të këtij neni, të përditësuar deri në momentin e kërkesës. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale i kërkon ofruesit të platformës online ose të motorit të kërkimit online, të japë informacion shtesë lidhur me llogaritjen e përmendur në atë pikë, përfshirë shpjegime dhe arsyetime në lidhje me të dhënat e përdorura. Informacioni i paraqitur nuk përfshin të dhëna personale.
4. Kur Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, bazuar në informacionin e marrë sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, ka arsye të konsiderojë se një ofrues i platformave online ose motorëve të kërkimit online, arrin pragun e mesatares mujore të marrësve aktive të shërbimit në Bashkimin Evropian të përcaktuara në pikën 1, të nenit 33, të këtij ligji, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale njofton për këtë Komisionin Evropian.

5. Ofruesit e platformave online i paraqesin pa vonesë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, vendimet dhe deklaratat e arsyeve të përmendura në pikën 1, të nenit 17, të këtij ligji. Ofruesit e platformave online sigurojnë që informacioni i paraqitur të mos përmbajë të dhëna personale.
6. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, miraton aktet zbatuese, lidhur me përcaktimin e modeleve, me formën, përmbajtjen dhe detaje të tjera të raporteve sipas pikës 1, të këtij neni, në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian.

Neni 25

Projektimi dhe organizimi i ndërfaqes online

1. Ofruesit e platformave online nuk krijojnë, organizojnë apo operojnë ndërfaqet e tyre online, në mënyrë që të mashtrojnë ose manipulojnë marrësit e shërbimit të tyre, ose në një mënyrë që shtrembërojnë ose dëmtojnë materialisht aftësinë e marrësve të shërbimit të tyre për të marrë vendime të lira dhe të informuara.
2. Ndalimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nuk zbatohet për praktikën e mbuluar nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, transponon udhëzimet e Komisionit Evropian mbi mënyrën e zbatimit të pikës 1, të këtij neni, në lidhje me praktika specifike, në veçanti:
 - a) dhënien e një dukshmërie më të madhe, përparësie për disa zgjedhje të caktuara, kur i kërkohet marrësit të shërbimit të marrë një vendim;
 - b) kërkimin në mënyrë të përsëritur nga marrësi i shërbimit për të bërë një zgjedhje, kur ajo zgjedhje është bërë tashmë, veçanërisht përmes shfaqjes së dritareve “*pop-up*” që ndërhyjnë në përvojën e përdoruesit;
 - c) rritjen e vështirësisë në procedurën e ndërprerjes së një shërbimi, krahasuar me procesin e abonimit në të.

Neni 26

Reklamat në platformat online

1. Ofruesit e platformave online, që paraqesin reklama në ndërfaqet e tyre online, sigurojnë që, për çdo reklamë specifike të paraqitur për çdo marrës individual të shërbimit, marrësit e shërbimit të jenë në gjendje të identifikojnë, në mënyrë të qartë, të përmbledhur dhe në kohë reale, sa vijon:
 - a) se informacioni përbën reklamë, përfshirë përmes shënimeve të dukshme, të cilat mund të ndjekin standardet në përputhje me nenin 44, të këtij ligji;
 - b) personin fizik ose juridik në emër të të cilit paraqitet reklama;
 - c) personin fizik ose juridik që ka paguar për reklamën, nëse ky person është i ndryshëm nga personi i përmendur në gjurmën b të kësaj pike;
 - ç) informacion domethënës, i aksesueshëm drejtpërdrejt dhe lehtësisht nga reklama, mbi parametrat kryesorë të përdorur për të përcaktuar marrësin të cilit i paraqitet reklama dhe kur është e aplikueshme, mbi mënyrën se si mund të ndryshohen këto parametra.
2. Ofruesit e platformave online, u sigurojnë marrësve të shërbimit, një funksionalitet për të deklaruar nëse përmbajtja që ata ofrojnë përbën ose përmban komunikime tregtare. Kur

marrësi i shërbimit bën një deklarin në përputhje me këtë paragraf, ofruesi i platformës online siguron që marrësit e tjerë të shërbimit të jenë në gjendje të identifikojnë, në mënyrë të qartë, të padiskutueshme dhe në kohë reale, përfshirë përmes shënimeve të dukshme që mund të ndjekin standardet në përputhje me nenin 44, të këtij ligji se përmbajtja e ofruar nga marrësi i shërbimit është ose përmban komunikime tregtare, siç është deklaruar.

3. Ofruesit e platformave online nuk u paraqesin marrësve të shërbimit reklama të bazuara në profilizim, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 124/2024 për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27

Transparenca e sistemeve rekomanduese

1. Ofruesit e platformave online që përdorin sisteme rekomanduese përcaktojnë në termat dhe kushtet e tyre, në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, parametrat kryesorë të përdorur në sistemet e tyre rekomanduese, si dhe çdo opsion për marrësit e shërbimit, për të modifikuar ose ndikuar në këta parametra kryesorë.
2. Parametrat kryesorë të përmendur në pikën 1, të këtij neni, shpjegojnë arsyen pse një informacion i caktuar i sugjerohet marrësit të shërbimit. Këto përfshijnë, të paktën:
 - a) kriteret që kanë peshën më të madhe në përcaktimin e informacionit të sugjeruar për marrësin e shërbimit;
 - b) arsyet e rëndësisë relative të këtyre parametrave.
3. Kur në përputhje me pikën 1, të këtij neni janë të disponueshme disa opsione për sistemet rekomanduese, që përcaktojnë renditjen relative të informacionit të paraqitur për marrësit e shërbimit, ofruesit e platformave online sigurojnë gjithashtu një funksionalitet që i mundëson marrësit të shërbimit të zgjedhë dhe të modifikojë në çdo kohë opsionin e tij të preferuar. Ky funksionalitet është drejtpërdrejtë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga seksioni specifik i ndërfaqes online të platformës ku informacionit po i jepet përparësi.

Neni 28

Mbrojtja e të miturve në internet

1. Ofruesit e platformave në internet të aksesueshme për të mitur, marrin masa të përshtatshme dhe proporcionale për të siguruar një nivel të lartë të privatësisë, sigurisë dhe mbrojtjes së të miturve, në shërbimin e tyre.
2. Ofruesit e platformës online, nuk paraqesin reklama në ndërfaqen e tyre të bazuara në profilizim, siç përkufizohet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, përkatësisht në ligjin 124/2024, duke përdorur të dhëna personale të marrësit të shërbimit, kur janë në dijeni në mënyrë të sigurtë se marrësi i shërbimit është i mitur.
3. Pajtueshmëria me detyrimet e përcaktuara në këtë nen, nuk i detyron ofruesit e platformave në internet të përpunojnë të dhëna personale shtesë për të vlerësuar nëse marrësi i shërbimit është i mitur.
4. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, miraton udhëzime, për të ndihmuar ofruesit e platformave online në zbatimin e pikës 1, të këtij neni, në përputhje me udhëzimet e Komisionit Evropian.

SEKSIONI 4
DISPOZITA SHITESË TË ZBATUESHME PËR OFRUESIT E PLATFORMAVE
ONLINE QË U LEJOJNË KONSUMATORËVE TË LIDHIN KONTRATA NË
DISTANCË ME TREGTARËT

Neni 29

Përfashtime për ndërmarrjet mikro dhe të vogla

1. Ky seksion nuk zbatohet për ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë që kualifikohen si ndërmarrje të vogla dhe mikro, sipas përkufizimit në Ligjin nr. 43/2022 “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.
2. Ky seksion nuk zbatohet gjithashtu për ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë që më parë kanë pasur statusin si ndërmarrje të vogla dhe mikro, për një periudhë prej 12 muajsh pas humbjes së këtij statusi.
3. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 1, të këtij neni, ky seksion zbatohet për ofruesit e platformave online që u lejojnë konsumatorëve të lidhin kontratat në distancë me tregtarët që janë cilësuar si platforma online shumë të mëdha në përputhje me nenin 33, pavarësisht nëse kualifikohen si ndërmarrje mikro apo të vogla.

Neni 30

Gjurmueshmëria e tregtarëve

1. Ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, sigurojnë që tregtarët i përdorin këto platforma online, për promovimin e mesazheve ose për t’i ofruar produkte ose shërbime konsumatorëve vendas, vetëm nëse, përpara përdorimit të shërbimeve të tyre për këto qëllime, ofruesit e platformave online kanë marrë nga tregtari informacionin e mëposhtëm, kur është i aplikueshëm:
 - a) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të tregtarit;
 - b) një kopje të dokumentit të identifikimit të tregtarit ose çdo identifikim tjetër elektronik sic përcaktohet në nenin 3, të ligjit nr. 51/2026 për identifikimin elektronik, shërbimet e besurara dhe portfolon e identitetit digjital;
 - c) të dhënat e llogarisë së pagesës së tregtarit;
 - d) kur tregtari është i regjistruar në një regjistër tregtar, ose në një regjistër tjetër publik të ngjashëm, regjistrin tregtar në të cilin është regjistruar tregtari dhe numrin e tij të regjistrimit, ose mjetin ekuivalent të identifikimit në atë regjistër;
 - e) një vetëdeklarim nga tregtari, me anë të të cilit ai angazhohet se do të ofrojë vetëm produkte ose shërbime që janë në përputhje me rregullat kombëtare të zbatueshme.
2. Pas marrjes së informacionit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, dhe përpara lejimit të përdorimit të shërbimeve të tij nga tregtari përkatës, ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, përmes përdorimit të çdo baze të dhënash zyrtare të aksesueshme lirisht online ose ndërfaqeje online, ose përmes kërkesave drejtuar tregtarit për paraqitjen e dokumenteve mbështetëse nga burime të besueshme, bën përpjekjet më të mira për të vlerësuar nëse informacioni i përmendur në gërmat a) deri në e) të pikës 1, të këtij neni, është i besueshëm dhe i plotë. Për qëllimet e këtij ligji, tregtarët mbajnë përgjegjësi për saktësinë e informacionit të dhënë.

3. Për sa u përket tregtarëve që tashmë përdorin shërbimet e ofruesve të platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët për qëllimet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, ofruesit bëjnë përpjekjet më të mira për të marrë informacionin e listuar nga tregtarët përkatës brenda një periudhe prej 12 muajsh. Kur tregtarët përkatës nuk arrijnë ta japin informacionin brenda kësaj periudhe, ofruesit pezullojnë ofrimin e shërbimeve të tyre për këta tregtarë derisa të kenë marrë të gjithë informacionin e kërkuar.
4. Kur ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, përfiton tregues të mjaftueshëm ose ka arsye të besojë se ndonjë element i informacionit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, i marrë nga tregtari përkatës, është i pasaktë, i paplotë ose jo i përditësuar, ai i kërkon tregtarit të korrigjojë situatën pa vonesë, ose brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar.
5. Nëse tregtari nuk e korrigjon ose nuk e plotëson atë informacion, ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, pezullon menjëherë ofrimin e shërbimit të tij për atë tregtar, në lidhje me ofrimin e produkteve ose shërbimeve për konsumatorët vendas, derisa kërkesa të jetë përmbushur plotësisht.
6. Nëse një ofrues i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, refuzon t'i lejojë një tregtari përdorimin e shërbimit të tij në përputhje me pikën 1, ose pezullon ofrimin e shërbimit të tij në përputhje me pikën 3 të këtij neni, tregtari përkatës ka të drejtë të paraqesë ankesë, siç parashikohet në nenet 20 dhe 21, të këtij ligji.
7. Ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, ruajnë informacionin e marrë në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në mënyrë të sigurt, për një periudhë prej gjashtë muajsh pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore me tregtarin përkatës. Më pas, ata e fshijnë informacionin.
8. Pa cënuar pikën 2, të këtij neni, ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, ua shfaq informacionin palëve të treta, vetëm kur kjo kërkohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, përfshirë urdhrat e përmendur në nenin 10, të këtij ligji, si dhe çdo urdhër të lëshuar nga autoritetet kompetente ose nga Koordinatori i Shërbimeve Digjitale për ushtrimin e detyrave të tyre, sipas këtij ligji.
9. Ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, e bën informacionin e përmendur në gërma a, d dhe e, të pikës 1, të këtij neni, të disponueshëm në platformën e tij online për marrësit e shërbimit në mënyrë të qartë, lehtësisht të aksesueshme dhe të kuptueshme. Ky informacion bëhet i disponueshëm të paktën në ndërfaqen online të platformës ku paraqitet informacioni mbi produktin ose shërbimin.

Neni 31

Pajtueshmëria në fazën e projektimit

1. Ofruesit e platformave online, që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, sigurojnë që ndërfaqja e tyre online të jetë e projektuar dhe e organizuar, në mënyrë që t'u mundësojë tregtarëve, të përmbushin detyrimet e tyre lidhur

- me informacionin parakontraktor, informacionin për sigurinë e produkteve dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore në fuqi..
2. Në veçanti, ofruesi përkatës siguron që ndërfaqja e tij online t'u mundësojë tregtarëve të japin informacion mbi emrin, adresën, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të operatorit ekonomik, i kuptuar si prodhues, përfaqësues i autorizuar, importues, shpërndarës, ofruesin e shërbimeve logjistike, ose çdo person fizik apo juridik tjetër që u nënshtrohet detyrimeve lidhur me prodhimin e produkteve, vendosjen e tyre në treg ose vënien në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 3. Ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët sigurojnë që ndërfaqja e tyre online të jetë e projektuar dhe e organizuar në mënyrë të tillë që t'u mundësojë tregtarëve të japin të paktën sa vijon:
 - a) informacionin e nevojshëm për identifikimin e qartë dhe të padiskutueshëm të produkteve ose shërbimeve të promovuara, ose të ofruara për konsumatorët e vendosur në Republikën e Shqipërisë, përmes shërbimeve të ofruesve;
 - b) çdo shenjë identifikuese të tregtarit, siç është marka tregtare, simboli ose logoja dhe,
 - c) kur është e aplikueshme, informacionin lidhur me etiketimin dhe shënjimin në përputhje me rregullat e zbatueshme për sigurinë e produkteve dhe pajtueshmërinë e produkteve të harmonizuar me rregullat e Bashkimit Evropian.
 4. Ofruesit e platformave online që u mundësojnë konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, vlerësojnë nëse këta tregtarë kanë dhënë informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përpara se t'u lejojnë atyre ofrimin e produkteve ose shërbimeve në këto platforma. Pasi tregtari lejohet për të ofruar produkte ose shërbime në platformën e tij online, që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, ofruesi bën përpjekje të arsyeshme për të verifikuar në mënyrë të rastësishme, në çdo bazë të dhënash zyrtare, të aksesueshme lirisht dhe të lexueshme nga makinat, ose në ndërfaqe online, nëse produktet, ose shërbimet e ofruara janë identifikuar si të paligjshme.

Neni 32

E drejta për informim

4. Kur një ofrues i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, merr dijeni, pavarësisht mjetit të përdorur, se një produkt ose shërbim i paligjshëm është ofruar për konsumatorët e vendosur në Republikën e Shqipërisë nga një tregtar përmes shërbimeve të tij, ai për aq sa disponon të dhënat e tyre të kontaktit, informon konsumatorët që kanë blerë produktin, ose shërbimin e paligjshëm, përmes shërbimeve të tij, për sa vijon:
 - a) faktin që produkti ose shërbimi është i paligjshëm;
 - b) identitetin e tregtarit; dhe
 - c) çdo mjet juridik përkatës për dëmshpërblim.
5. Detyrimi i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, kufizohet në blerjet e produkteve ose shërbimeve të paligjshme të kryera brenda gjashtë muajve, përpara momentit kur ofruesi merr dijeni për paligjshmërinë.
6. Kur, në situatën e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ofruesi i platformës online që u mundëson konsumatorëve lidhjen e kontratave në distancë me tregtarët, nuk disponon të dhënat e kontaktit të të gjithë konsumatorëve të përfshirë, ai e bën publik dhe lehtësisht të

aksesueshem, në ndërfaqen e tij online informacionin lidhur me produktin ose shërbimin e paligjshëm, identitetin e tregtarit dhe çdo mjet përkatës të ushtrimit të të drejtave.

SEKSIONI 5

DETYRIME SHITESË PËR OFRUESIT E PLATFORMAVE ONLINE SHUMË TË MËDHA DHE MOTORËVE TË KËRKIMIT ONLINE SHUMË TË MËDHENJ PËR MENAXHIMIN E RREZIQEVE SISTEMIKE

Neni 33

Platformat online shumë të mëdha dhe motorët e kërkimit online shumë të mëdhenj

1. Ky seksion zbatohet për platformat online dhe motorët e kërkimit online, që janë përcaktuar nga Komisioni Evropian si platforma online shumë të mëdha dhe motorë kërkimi online shumë të mëdhenj, pavarësisht numrit të marrësve aktivë të shërbimit në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të atyre që nuk ofrojnë shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, publikon në faqen e tij të internetit, listën e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, të përcaktuar nga Komisioni Evropian dhe e përditëson atë menjëherë, sa herë që lista e Komisionit ndryshohet.
3. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale e heq ofruesin e platformës online ose të motorit të kërkimit online nga lista e platformave online shumë të mëdha ose motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj për Shqipërinë, sapo përcaktimi i tij si VLOPSE në Evropë të hiqet.
4. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale njofton menjëherë, ofruesin përkatës të platformës online ose të motorit të kërkimit online, për përfshirjen e tij në listën e platformave online shumë të mëdha ose motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj për Shqipërinë, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni.

Neni 34

Vlerësimi i rrezikut

1. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, identifikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë me kujdes çdo rrezik sistematik në Republikën e Shqipërisë, lidhur me projektimin ose funksionimin e shërbimeve dhe sistemeve të lidhura me to, përfshirë sistemet algoritmike, apo nga përdorimi i shërbimeve të tyre. Vlerësimi i rrezikut kryhet deri në datën e aplikimit sipas pikës 4, të nenit 33, të këtij ligji, dhe të paktën një herë në vit pas kësaj, si dhe, në çdo rast, përpara vendosjes në përdorim të funksionaliteteve që mund të kenë ndikim kritik mbi rreziqet e identifikuara në përputhje me këtë nen. Vlerësimi i rrezikut është specifik për shërbimet e tyre dhe proporcional me rreziqet e sistemeve, dhe merr në konsideratë ashpërsinë dhe probabilitetin e tyre ku përfshihen rreziqet sistematike të mëposhtme:
 - a) shpërndarja e përmbajtjes së paligjshme përmes shërbimeve të tyre;
 - b) çdo efekt negativ aktual ose i parashikueshëm mbi ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
 - c) çdo efekt negativ aktual ose i parashikueshëm mbi debatin qytetar, proceset zgjedhore, si dhe rendin publik;

- ç) çdo efekt negativ aktual ose i parashikueshëm në lidhje me dhunën me bazë gjinore, mbrojtjen e shëndetit publik dhe të të miturve, si dhe pasoja serioze negative për mirëqenien fizike dhe mendore të personit.
2. Gjatë kryerjes së vlerësimeve të rrezikut, ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, marrin në konsideratë, në veçanti, nëse dhe në ç'mënyrë ndonjë prej rreziqeve sistemike të përmendura në pikën 1, të këtij neni ndikohet nga faktorët e mëposhtëm:
- a) projektimi i sistemeve të tyre rekomanduese dhe çdo sistemi tjetër algoritmik përkatës;
 - b) sistemet e tyre të shqyrtimit të përmbajtjes;
 - c) termat dhe kushtet e përdorimit dhe garantimi i respektimit të tyre;
 - ç) sistemet e tyre për përzgjedhjen dhe paraqitjen e reklamave;
 - d) praktikrat e ofruesit lidhur me të dhënat.
- Vlerësimet gjithashtu marrin në konsideratë, rreziqet e përmendura në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, dhe nëse ato ndikohen dhe, si ndikohen nga manipulimi i qëllimshëm i shërbimit të tyre, përfshirë përdorimin joautentik ose shfrytëzimin e automatizuar të shërbimit, si dhe nga amplifikimi dhe shpërndarja potencialisht e shpejtë dhe e gjerë e përmbajtjes së paligjshme dhe informacionit të papajtueshëm me termat dhe kushtet. Në vlerësime merren parasysh edhe aspektet specifike rajonale ose gjuhësore.
3. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, ruajnë dokumentacionin mbështetës të vlerësimeve të rrezikut, për të paktën tre vjet pas kryerjes së këtyre vlerësimeve dhe me kërkesë, ia paraqesin atë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.

Neni 35

Masat për zbutjen e rreziqeve

1. Ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe të motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, marrin masa zbutëse të arsyeshme, proporcionale dhe efektive, të përshtatura sipas rreziqeve specifike sistemike të identifikuara në përputhje me nenin 34, të këtij ligji, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të këtyre masave mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Këto masa përfshijnë, kur është e përshtatshme:
- a) përshtatjen e projektimit, karakteristikave ose funksionimit të shërbimeve të tyre, përfshirë ndërfaqet online;
 - b) përshtatjen e termave dhe kushteve dhe garantimin e respektimit të tyre;
 - c) përshtatjen e proceseve të moderimit të përmbajtjes, përfshirë shpejtësinë dhe cilësinë e trajtimit të njoftimeve, lidhur me lloje specifike të përmbajtjes së paligjshme dhe kur është e përshtatshme, heqjen ose çaktivizimin e menjëhershëm të aksesit në përmbajtjen e njoftuar, veçanërisht në lidhje me gjuhën e urrejtjes së paligjshme ose dhunën online, si dhe përshtatjen e proceseve përkatëse të vendimmarrjes dhe burimeve të dedikuara për shqyrtimin e përmbajtjes;
 - ç) testimin dhe përshtatjen e sistemeve algoritmike, përfshirë sistemet rekomanduese;
 - d) përshtatjen e sistemeve të reklamimit dhe miratimin e masave specifike që synojnë kufizimin ose përshtatjen e paraqitjes së reklamave të lidhura me shërbimin që ato ofrojnë;

- dh)forcimin e proceseve të tyre të brendshme, burimeve, kapaciteteve të testimit, dokumentacionit ose mbikëqyrjes së çdo veprimtarie të tyre, veçanërisht përsa i përket zbulimit të rreziqeve sistemike;
- e) fillimin ose përshtatjen e bashkëpunimit me sinjalizuesit e besuar, në përputhje me nenin 22, të këtij ligji dhe zbatimin e vendimeve të organeve të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, sipas nenit 21, të këtij ligji;
- ë) fillimin ose përshtatjen e bashkëpunimit me ofrues të tjerë të platformave online, ose motorëve të kërkimit online, përmes kodeve të sjelljes dhe protokolleve të krizës, të përmendura respektivisht në nenet 45 dhe 48, të këtij ligji;
- f) miratimin e masave ndërgjegjësuere dhe përshtatjen e ndërfaqeve online për të ofruar më shumë informacion për marrësit e shërbimit;
- g) miratimin e masave specifike për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, përfshirë mjetet e verifikimit të moshës dhe kontrollit prindëror, ose mjetet që ndihmojnë të miturit të raportojnë abuzimin ose të marrin mbështetje, sipas rastit;
- gj) sigurimin që informacioni, i cili mund të marrë formën e një imazhi të gjeneruar, edhe përmes proceseve të inteligjencës artificiale, ose të manipuluar, apo të përmbajtjes audio ose video të gjeneruar, përfshirë përmes proceseve të inteligjencës artificiale, ose të manipuluar, që ngjan në mënyrë thelbësore me persona, objekte, vende, subjekte ose ngjarje ekzistuese dhe që paraqitet në mënyrë të rreme si autentik ose i vërtetë, të mund të dallohet përmes shenjave të dukshme kur paraqitet në ndërfaqet e tyre online dhe për më tepër, të ofrohet një funksionalitet lehtësisht i përdorshëm që u mundëson marrësve të shërbimit të tregojnë një informacion të tillë.
2. Koordinatori Kombëtar i Shërbimeve Digjitale, publikon raporte gjithëpërfshirëse një herë në vit që përfshijnë sa vijon:
- a) identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve sistemike më të rëndësishme dhe më të përsëritura, të raportuara nga ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, ose të identifikuara përmes burimeve të tjera të informacionit, veçanërisht ato të përcaktuara në përputhje me nenet 39, 40 dhe 42, të këtij ligji;
- b) praktikat më të mira për ofruesit e platformave online shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, për zbutjen e rreziqeve sistemike të identifikuara.
3. Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, mund të nxjerrë udhëzime mbi zbatimin e pikës 1, të këtij neni, në lidhje me rreziqet specifike, veçanërisht për të paraqitur praktikat më të mira dhe për të rekomanduar masa të mundshme, duke marrë parasysh në mënyrë të duhur pasojat e mundshme të masave mbi të drejtat e të gjitha palëve të përfshira. Gjatë hartimit të këtyre udhëzimeve, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale në bashkëpunim me autoritetet kompetente në zbatim të këtij ligji, analizon legjislacionin dhe praktikat e Bashkimit Evropian dhe organizon konsultime publike.

Neni 36

Mekanizmi i reagimit ndaj krizave

1. Në rast të një situate krize, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të nxjerrë një vendim me anë të të cilit kërkon nga një ose më shumë ofrues të platformave online shumë

të mëdha ose motorëve të kërkimit online shumë të mëdhenj, të kryejnë një ose më shumë nga veprimet e mëposhtme:

- a) të vlerësojë nëse ka, dhe në çfarë mase dhe në ç'mënyrë funksionimi dhe përdorimi i shërbimeve të tyre, kontribuon ose ka të ngjarë të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme, në një kërcënim serioz të përmendur në pikën 3, të këtij neni;
- b) të identifikojë dhe zbatojë masa specifike, efektive dhe proporcionale, si ato të parashikuara në pikën 1, të nenit 35 të këtij ligji, ose në pikën 2, të nenit 46 të këtij ligji, për të parandaluar, eliminuar ose kufizuar çdo kontribut të tillë ndaj kërcënimit serioz të identifikuar, në përputhje me germën a), të kësaj pike;
- c) t'i raportojë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, brenda një afati të caktuar ose në intervale të rregullta të përcaktuara në vendim, mbi vlerësimet e përmendura në germën a), të kësaj pike, mbi përmbajtjen e saktë, zbatimin dhe ndikimin cilësor dhe sasior të masave specifike të marra sipas germës b), të kësaj pike, si dhe mbi çdo çështje tjetër që lidhet me këto vlerësime ose masa, sipas përcaktimeve të vendimit.

Kur identifikon dhe zbaton masat sipas germës b), të pikës 1, të këtij neni, ofruesi i shërbimit merr në konsideratë si duhet seriozitetin e kërcënimit të përmendur në pikën 3, të këtij neni, urgjencën e masave dhe pasojat aktuale ose të mundshme, për të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të përfshira, përfshirë mundësinë që masat të mos respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

2. Për qëllimet e këtij neni, konsiderohet se ekziston ose po ndodh një situatë krize, kur rrethana të jashtëzakonshme krijojnë një kërcënim serioz ndaj rendit publik, proceseve zgjedhore ose shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë.
3. Në rastin e nxjerrjes së një vendimi të përmendur në pikën 1, të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, siguron që të plotësohen në mënyrë kumulative kërkesat e mëposhtme:
 - a) veprimet e kërkuara nga vendimi të jenë ose tejet të nevojshme, të justifikuara dhe proporcionale, duke marrë parasysh veçanërisht seriozitetin e kërcënimit të përmendur në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, urgjencën e marrjes së masave dhe pasojat aktuale ose të mundshme për të drejtat dhe interesat legjitime të të gjitha palëve të përfshira, duke marrë parasysh edhe mundësinë që masat të mos respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
 - b) vendimi të përcaktojë një afat të arsyeshëm, brenda të cilit merren masat specifike të përmendura në germën b, të pikës 1, të këtij neni, duke marrë parasysh, në veçanti, urgjencën e këtyre masave dhe kohën e nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e tyre;
 - c) veprimet e kërkuara nga vendimi, të kufizohen brenda një periudhe kohore tre mujore.
4. Në përputhje me vendimin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në mënyrë të menjëhershme, ndërmerr veprimet e mëposhtme:
 - a) informon ofruesin për nxjerrjen e vendimit;
 - b) e bën vendimin të disponueshëm për publikun.
5. Përzgjedhja e masave specifike, që miratohen në përputhje me germën b, të pikës 1 dhe pikës 9, të këtij neni, mbetet në diskrecionin e ofruesit.
6. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë, me iniciativën e vet, ose me kërkesë të ofruesit, të zhvillojë dialog me ofruesin për të përcaktuar nëse, duke marrë parasysh rrethanat specifike të ofruesit, masat e parashikuara ose të zbatuara të përmendura në germën b), të pikës 1, të këtij neni, janë efektive dhe proporcionale për arritjen e objektivave

- të synuara. Koordinator i Shërbimeve Digjitale siguron që masat e marra nga ofruesi i shërbimit sipas gjurmës b), të pikës 1, të këtij neni, të përmbushin kërkesat e përmendura në gjërmat a, dhe c, të pikës 4, të këtij neni.
7. Koordinator i Shërbimeve Digjitale monitoron zbatimin e masave specifike të marra në përputhje me vendimin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, mbi bazën e raporteve të përmendura në gjurmën c, të pikës 1 dhe çdo informacioni tjetër përkatës, përfshirë informacionin që mund të kërkojë në përputhje me nenin 40, të këtij ligji, duke marrë parasysh zhvillimin e situatës së krizës.
 8. Kur Koordinator i Shërbimeve Digjitale konsideron se masat specifike të parashikuara ose të zbatuara sipas gjurmës b, të pikës 1, të këtij neni nuk janë efektive ose proporcionale, ai ka të drejtë të nxjerrë një vendim të ri, duke i kërkuar ofruesit të rishikojë masat specifike të identifikuar, ose mënyrën e zbatimit të tyre. Duke marrë parasysh zhvillimin e situatës së krizës, Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të ndryshojë vendimin e përmendur në pikat 1 ose 9, të këtij neni duke:
 - a) revokuar aktin dhe kur është e aplikueshme, duke kërkuar nga platforma online shumë e madhe ose motori i kërkimit online shumë i madh, të ndalojë zbatimin e masave të identifikuar dhe të zbatuara sipas gjurmës b, të pikës 1, ose pikës 9, të këtij neni, veçanërisht kur arsyet për zbatimin e këtyre masave nuk ekzistojnë më;
 - b) zgjatur periudhën e përmendur në gjurmën c, të pikës 4, të këtij neni, për një periudhë që nuk tejkalon tre muaj;
 - c) marrë parasysh përvojën e fituar nga zbatimi i masave, në veçanti mundësinë që masat të mos respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
 9. Kërkesat e pikave 1 deri në 6, të këtij neni, zbatohen edhe për vendimin dhe ndryshimin e tij, të përmendur në këtë nen.

Neni 37 **Auditimi i pavarur**

1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i nënshtrohen, me shpenzimet e tyre dhe të paktën një herë në vit, auditimeve të pavarura, për të vlerësuar përputhshmërinë me sa vijon:
 - a) detyrimet e përcaktuara në Kreun III, të këtij ligji;
 - b) çdo angazhim të ndërmarrë në kuadër të kodeve të sjelljes të përmendura në nenet 45, dhe 46, të këtij ligji, dhe protokollet e krizës të përmendura në nenin 48, të këtij ligji.
2. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, u ofrojnë subjekteve që kryejnë auditimet sipas këtij neni, bashkëpunimin dhe asistencën e nevojshme për t'u mundësuar atyre kryerjen e këtyre auditimeve në mënyrë efektive, efikase dhe në kohë, duke u siguruar akses në të gjitha të dhënat dhe ambientet përkatëse, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtëpërdrejta ose me shkrim. Ata evitojnë pengimin, ndikimin e tepruar ose shmangjen e kryerjes së auditimit. Auditimet garantojnë një nivel të përshtatshëm konfidencialiteti dhe sekretit profesional, në lidhje me informacionin e marrë nga ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, si dhe nga palët e treta, në kuadër të auditimeve, përfshirë edhe periudhën pas përfundimit të tyre. Përputhshmëria me këtë kërkesë, nuk çënon zhvillimin e auditimeve dhe dispozitat e tjera të këtij ligji, veçanërisht dispozitat mbi transparencën, mbikëqyrjen dhe zbatimin. Kur është e nevojshme për qëllime të raportimit të transparencës sipas pikës 4 të nenit 42, të këtij ligji, raporti i auditimit dhe raporti mbi zbatimin e masave pasuese të rekomanduara nga auditimi, të

përmendura në pikat 5, dhe 7, të këtij neni, shoqërohen me versione që nuk përmbajnë informacion që mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme konfidencial.

3. Auditimet e kryera sipas pikës 1, të këtij neni, kryhen nga organizata të cilat:
 - a) janë të pavarura nga, dhe nuk kanë konflikt interesi me ofruesin e platformës shumë të madhe online ose të motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë dhe çdo person tjetër juridik të lidhur me atë ofrues, në veçanti:
 - i. nuk i kanë ofruar ofruesit të platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë, ose ndonjë personi juridik të lidhur me atë ofrues, shërbime të tjera pa lidhje me auditimin ose çështje të audituara gjatë 12 muajve para fillimit të auditimit dhe marrin përsipër të mos ofrojnë shërbime të tilla gjatë 12 muajve pas përfundimit të procesit të auditimit;
 - ii. nuk kanë ofruar shërbime auditimi sipas këtij neni, për ofruesin e platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë, ose për ndonjë person juridik të lidhur me atë ofrues për më shumë se 10 vite radhazi;
 - iii. nuk kryejnë auditimin kundrejt tarifave që varen nga rezultati i auditimit;
 - b) kanë ekspertizë të provuar në menaxhimin e rrezikut, si dhe aftësi dhe kapacitete teknike;
 - c) kanë objektivitet dhe etikë profesionale të provuar, veçanërisht duke respektuar kode praktike ose standarde të përshtatshme.
4. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, sigurojnë që audituesit të hartojnë një raport auditimi për çdo auditim. Ky raport duhet të jetë i arsyetuar, i hartuar me shkrim dhe të përfshijë të paktën elementet e mëposhtme:
 - a) emrin, adresën dhe pikën e kontaktit të ofruesit të platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit online subjekt auditimi, si dhe periudhën që mbulon auditimi;
 - b) emrin dhe adresën e organizatës ose organizatave që kryejnë auditimin;
 - c) një deklaratë interesi;
 - d) një përshkrim të elementeve specifike të audituara dhe metodologjisë së zbatuar;
 - e) një përshkrim dhe përmbledhje të gjetjeve kryesore të auditimit;
 - f) një listë të palëve të treta të konsultuara gjatë auditimit;
 - g) një opinion mbi përputhshmërinë e ofruesit të platformës shumë të madhe online ose motorit shumë të madh të kërkimit online subjekt auditimi, me detyrimet dhe angazhimet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, i cili mund të rezultojë pozitiv, me vërejtje ose negativ;
 - h) kur opinionin i auditimit nuk është pozitiv, audituesit japin rekomandime operative mbi masat specifike të përputhshmërisë dhe afatin kohor të rekomanduar për arritjen e përputhshmërisë me këto masa.
5. Kur kompania audituese nuk ka qenë në gjendje të auditojë elemente specifike ose të shprehë një opinion auditimi, bazuar në hetimet e saj, raporti i auditimit përfshin një shpjegim të rrethanave dhe arsyeve për të cilat këto elemente nuk mund të auditoheshin.
6. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online ose motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, që marrin një raport auditimi jo pozitiv, marrin në konsideratë rekomandimet operative, me synim marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e tyre. Brenda një muaji nga marrja e rekomandimeve, këta ofrues miratojnë një raport mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga auditimi. Kur nuk zbatojnë rekomandimet operative, ata justifikojnë në raportin mbi zbatimin e auditimit, arsyet për moszbatimin e rekomandimeve operative dhe paraqesin masat alternative që kanë ndërmarrë për të adresuar çdo rast të mospërputhshmërisë së identifikuar.
7. Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të miratojë rregullat për kryerjen e auditimeve sipas këtij neni, veçanërisht në lidhje me rregullat e nevojshme mbi hapat proceduralë, metodologjitë e auditimit dhe modelet e raportimit për auditimet e kryera sipas

- këtij neni. Këto rregulla marrin në konsideratë çdo standard auditimi vullnetar të përmendur në gjermanin e), të pikës 1, të nenit 44, të këtij ligji.
8. Koordinator i Shërbimeve Digjitale përcakton karakteristikat e subjekteve të përmendura në gjermanin b, pika 1, e nenit 33, të këtij ligji, ndaj të cilave zbatohen dispozitat e këtij neni.

Neni 38

Sistemet e rekomandimit

Përveç kërkesave të përcaktuara në nenin 27, të këtij ligji, ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, që përdorin sisteme rekomandimi, ofrojnë, për secilin nga sistemet e tyre të rekomandimit, të paktën një opsion që nuk bazohet në profilizim, sipas nenit 4 të Ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 39

Detyrime shtesë për transparencën për reklamën online

1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, që paraqesin reklama në ndërfaqet e tyre online, hartojnë dhe bëjnë të disponueshme për publikun, në një seksion të posaçëm të ndërfaqes së tyre online përmes një mjeti kërkimi të besueshëm, që lejon kërkime bazuar në shumë kritere, si dhe përmes ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API), një regjistër që përmban informacionin e përmendur në pikën 2, të këtij neni, për gjithë periudhën gjatë të cilës paraqitet reklama dhe deri në një vit pasi reklama është shfaqur për herë të fundit në ndërfaqen e tyre online. Ata sigurojnë që regjistri të mos përmbajë të dhëna personale të marrësve të shërbimit tek të cilët është shfaqur ose mund t’u jetë paraqitur reklama dhe bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që informacioni të jetë i saktë dhe i plotë.
2. Regjistri përfshin të paktën të gjithë informacionin e mëposhtëm:
 - a) përmbajtjen e reklamës, përfshirë emrin e produktit, shërbimit ose markës tregtare dhe objektin e reklamës;
 - b) personin fizik ose juridik në emër të të cilit paraqitet reklama;
 - c) personin fizik ose juridik që paguan për reklamën, nëse ky person është i ndryshëm nga personi i përmendur në gjermanin “b” të kësaj pike;
 - d) periudhën gjatë të cilës është paraqitur komunikimi i reklamës;
 - e) nëse reklama synonte shfaqjen tek një ose më shumë grupe specifike të marrësve të shërbimit dhe parametrat kryesorë të përdorur për këtë qëllim, përfshirë parametrat kryesorë të përdorur për të përjashtuar një ose më shumë grupe të tilla specifike, sipas rastit;
 - f) komunikimet tregtare të publikuara në platforma shumë të mëdha online dhe të identifikuara sipas, pikës 2 të nenit 26, të këtij ligji;
 - g) numrin total të marrësve të shërbimit, të cilëve u është shfaqur reklama dhe sipas rastit, numrin total, të ndarë sipas grupit ose grupeve të marrësve ndaj të cilëve reklama është drejtuar në mënyrë specifike.
3. Në lidhje me gjermanin a), b) dhe c) të pikës 2, të këtij neni, kur ofruesi i një platforme shumë të madhe online ose i një motori shumë të madh të kërkimit online, ka hequr ose bllokuar aksesin në një komunikim të caktuar reklame mbi bazën e një paligjshmërie të pretenduar

ose mospërputhshmërie me kushtet dhe afatet, regjistri nuk përfshin informacionin e përmendur në këto gërma. Në këtë rast, regjistri përfshin, për komunikimin e reklamës specifike në fjalë, informacionin e përmendur në gërmat a) deri në dh), të pikës 3, të nenit 17, të këtij ligji, ose sipas rastit, informacionin sipas nënpikës i., të gërmës a), në pikën 2, të nenit 9, të këtij ligji. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të nxjerrë udhëzime mbi strukturën, organizimin dhe funksionet e regjistrave të përmendur në këtë nen.

Neni 40

Aksesi në të dhëna dhe shqyrtimi

1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i sigurojnë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, me kërkesën e tij të arsyetuar dhe brenda një periudhe të arsyeshme të përcaktuar në këtë kërkesë, akses në të dhënat e nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë me këtë ligj.
2. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale përdor të dhënat e aksesueshme sipas pikës 1, të këtij neni, vetëm për qëllimin e monitorimit dhe vlerësimit të përputhshmërisë me këtë ligj, duke respektuar të drejtat dhe interesat e ofruesve të platformave shumë të mëdha online, ose motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online dhe të marrësve të shërbimit, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e informacionit konfidencial, në veçanti sekretet tregtare, si dhe ruajtjen e sigurisë së shërbimeve të tyre.
3. Në përputhje me pikën 1, të këtij neni, ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, me kërkesë të Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, japin shpjegime mbi projektimin, logjikën, funksionimin dhe testimin e sistemeve të tyre algoritmike, përfshirë sistemet rekomanduese.
4. Me kërkesë të arsyetuar të Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online sigurojnë, brenda një periudhe të arsyeshme të përcaktuar në kërkesë, akses në të dhëna për studiuesit e miratuar, që plotësojnë kërkesat e pikës 8, të këtij neni, vetëm për qëllimin e kryerjes së kërkimeve që kontribuojnë në zbulimin, identifikimin dhe kuptimin e rreziqeve sistemike për Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohen pikat 1 dhe 2 të nenit 34, të këtij ligji, si dhe në vlerësimin e përshtatshmërisë, efektivitetit dhe ndikimit të masave për zbutjen e rrezikut sipas nenit 35, të këtij ligji.
5. Brenda 15 ditëve nga marrja e një kërkesë të përmendur në pikën 4, të këtij neni, ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i kërkojnë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale rishikimin e kërkesës, kur konsiderojnë se nuk janë në gjendje të japin akses në të dhënat e kërkuara për njërin nga dy arsytet e mëposhtme:
 - a) nuk kanë akses në të dhënat;
 - b) dhënia e aksesit në të dhëna do të çonte në cënime të rëndësishme të sigurisë së shërbimit të tyre, ose të mbrojtjes së informacionit konfidencial, në veçanti sekreteve tregtare.
6. Kërkesat për ndryshim sipas pikës 5, të këtij neni, përmbajnë propozime për një ose më shumë mënyra alternative, përmes të cilave mund të jepet akses në të dhënat e kërkuara, ose në të dhëna të tjera që janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për qëllimin e kërkesës. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale vendos mbi kërkesën për ndryshim, brenda 15 ditëve dhe i komunikon ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, vendimin e tij dhe sipas rastit, kërkesën e ndryshuar dhe afatin e ri për përmbushjen e saj.
7. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, sigurojnë dhe lehtësojnë aksesin në të dhëna sipas pikave 1 dhe 4, të këtij neni, përmes ndërfaqeve të përshtatshme të përcaktuara në kërkesë, duke përfshirë bazat e të dhënave online ose ndërfaqet e programimit të aplikacioneve (API).

8. Me një kërkesë të arsyetuar nga studiuesit, Koordinator i Shërbimeve Digjitale u jep këtyre studiuesve statusin e studiuesit të miratuar, në lidhje me një kërkim specifik të përmendur në kërkesë dhe nxjerr një kërkesë të arsyetuar për akses në të dhënat e ofruesit të një platforme shumë të madhe online, ose motori shumë të madh të kërimit online, sipas pikës 4, të këtij neni, kur studiuesit provojnë se plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) janë të lidhur me një organizatë kërkimore e cila, për qëllimet e këtij neni, është një universitet, përfshirë bibliotekat e tij, apo një institut ose entitet tjetër kërkimor, qëllimi kryesor i të cilit është kryerja e kërimit shkencor ose zhvillimi i aktiviteteve arsimore që përfshin gjithashtu kryerjen e kërimit shkencor pa qëllime fitimi ose që riinveston të gjitha fitimet në kërkimin shkencor, ose kryhet mbi bazën e një misioni në interes publik, në mënyrë që nga aksesit në rezultatet e krijuara nga ky kërkim shkencor të mos përfitojë në mënyrë preferenciale një ndërmarrje që ushtron ndikim vendimtar mbi këtë organizatë;
 - b) nuk kanë interesa tregtare;
 - c) kërkesa e tyre tregon burimin e financimit për kërkimin;
 - ç) janë në gjendje të respektojnë kërkesat specifike për sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave që korrespondojnë me çdo kërkesë dhe të mbrojnë të dhënat personale, si dhe të përshkruajnë në kërkesën e tyre masat e përshtatshme teknike dhe organizative që kanë marrë për këtë qëllim;
 - d) kërkesa e tyre demonstroi se aksesit në të dhëna dhe periudhat për të cilat kërkohet aksesit, janë të nevojshme dhe proporcionale me qëllimet e kërimit të tyre dhe se rezultatet e pritshme të kërimit do të kontribuojnë në qëllimet e përcaktuara në pikën 4, të këtij neni;
 - dh) aktivitetet kërkimore të planifikuara kryhen për qëllimet e përcaktuara në pikën 4, të këtij neni;
 - e) brenda një periudhe të arsyeshme pas përfundimit të kërimit, kanë marrë përsipër t'i bëjnë rezultatet e kërimit të disponueshme për publikun, pa pagesë, duke respektuar të drejtat dhe interesat e marrësve të shërbimit në fjalë, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
9. Koordinator i Shërbimeve Digjitale revokon statusin e studiuesit të miratuar nëse ai konstaton, pas një hetimi të kryer me nismën e vet ose mbi bazën e informacionit të marrë nga palë të treta, se studiuesi i miratuar nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara në pikën 8, të këtij neni dhe informon ofruesin e platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërimit online në fjalë për vendimin. Përpara heqjes së aksesit, Koordinator i Shërbimeve Digjitale i jep studiuesit të miratuar mundësinë për të reaguar ndaj gjetjeve të hetimit të tij dhe synimit për të hequr aksesin.
10. Koordinator i Shërbimeve Digjitale publikon në faqen e tij të internetit listën e emrave dhe të dhënat e kontaktit për personat fizike ose subjektet që kanë marrë statusin e “studjuesit të miratuar” në përputhje me pikën 8, të këtij neni si dhe qëllimin e studimit për të cilin është bërë kërkesa.
11. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërimit online japin akses në të dhëna pa vonesë të panevojshme, dhe kur është teknikisht e mundur, të dhëna në kohë reale, ku këto të dhëna janë publikisht të arritshme nga studiuesit në ndërfaqen e tyre online, përfshirë ato të lidhura me organe, organizata dhe shoqata jofitimprurëse, të cilët përmbushin kushtet e përcaktuara në gërmat b), c), d) dhe e), të pikës 8, të këtij neni dhe që i përdorin të dhënat vetëm për kryerjen e kërkimeve që kontribuojnë në zbulimin, identifikimin dhe kuptimin e rreziqeve sistematike në përputhje me pikën 1, të nenit 34, të këtij ligji.
12. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, miraton kushtet teknike sipas të cilave ofruesit e platformave shumë të mëdha online ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërimit online

ofrojnë akses në të dhënat sipas pikave 1 dhe 4 të këtij neni, si dhe qëllimet për të cilat këto të dhëna mund të përdoren, në përputhje me aktet zbatuese përkatëse të miratuara nga Komisioni Evropian.

Neni 41 **Funksioni i përputhshmërisë**

1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, krijojnë një funksion përputhshmërie, i cili është i pavarur nga funksionet operacionale dhe përbëhet nga një ose më shumë zyrtarë të përputhshmërisë, përfshirë drejtuesin e funksionit të përputhshmërisë. Ky funksion përputhshmërie ka autoritet, status dhe burime të mjaftueshme, si dhe akses në organin drejtues të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, për të monitoruar përputhshmërinë e këtij ofruesi, me këtë ligj.
2. Organi drejtues i ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, siguron që zyrtarët e përputhshmërisë të kenë kualifikimet profesionale, njohuritë, përvojën dhe kapacitetin e nevojshëm për të kryer detyrat e përmendura në pikën 3, të këtij neni. Organi drejtues i ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, siguron që drejtuesi i funksionit të përputhshmërisë të jetë pjesë e drejtimit të lartë të pavarur, me përgjegjësi të veçanta për funksionin e përputhshmërisë. Drejtuesi i funksionit të përputhshmërisë, i raporton drejtpërdrejt organit drejtues të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, në mënyrë të pavarur nga drejtimi i lartë, dhe ngre shqetësime dhe paralajmëron organin drejtues kur rreziqet e përmendura në nenin 34, të këtij ligji, ose mospërputhshmëria me këtë ligj, prekin ose mund të prekin ofruesin e platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online në fjalë, pa cënuar përgjegjësitë e organit drejtues lidhur me funksionet e tij mbikëqyrëse dhe administruese. Drejtuesi i funksionit të përputhshmërisë nuk mund të shkarkohet pa miratimin paraprak të organit drejtues të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online.
3. Zyrtarët e përputhshmërisë kanë këto detyra:
 - a) bashkëpunimin me Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale për qëllimet e këtij ligji;
 - b) sigurimin që të gjitha rreziqet e përmendura në nenin 34, të këtij ligji, të identifikohen dhe raportohen dhe të merren masa të arsyeshme, proporcionale dhe efektive për zbutjen e rrezikut në përputhje me nenin 35, të këtij ligji;
 - c) organizimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, lidhur me auditimin e pavarur sipas nenit 37, të këtij ligji;
 - ç) informimin dhe këshillimin e drejtimit dhe punonjësve të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, mbi detyrimet përkatëse sipas këtij ligji;
 - d) monitorimin e përputhshmërisë së ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, me detyrimet e tij, sipas këtij ligji
 - dh) sipas rastit, monitorimin e përputhshmërisë të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, me angazhimet e ndërmarra në kuadër të kodeve të sjelljes sipas nenit 45, të këtij ligji, ose protokolleve të krizës sipas nenit 46, të këtij ligji .
4. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i komunikojnë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, emrin dhe të dhënat e kontaktit të drejtuesit të funksionit të përputhshmërisë.
5. Organi drejtues i ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, përcakton, mbikëqyr dhe mban përgjegjësi për zbatimin e strukturave

drejtuese së ofruesit, që garantojnë pavarësinë e shërbimit që siguron funksionin e përputhshmërisë, përfshirë ndarjen e përgjegjësisë brenda organizimit të ofruesit të platformës shumë të madhe online, ose motorit shumë të madh të kërkimit online, parandalimin e konflikteve të interesit dhe miremenaxhimit e rreziqeve sistematike të identifikuar sipas nenit 34, të këtij ligji.

6. Organi drejtues miraton dhe rishikon rregullisht, të paktën një herë në vit, strategjitë dhe politikat për të menaxhuar, monitoruar dhe zbutur rreziqet e identifikuar sipas nenit 34, të këtij ligji, ndaj të cilave platforma shumë e madhe online, ose motori shumë i madh i kërkimit online, është ose mund të jetë i ekspozuar.

7. Organi drejtues siguron kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e masave të menaxhimit të rrezikut. Ai merr pjesë aktive në vendimmarrjen lidhur me menaxhimin e rrezikut dhe siguron që burime të përshtatshme të alokohen për menaxhimin e rreziqeve të identifikuar në përputhje me nenin 34, të këtij ligji.

Neni 42

Detyrimet për raportimin e transparencës

1. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, publikojnë raportet e përmendura në nenin 15, të këtij ligji, jo më vonë se dy muaj pas datës së zbatimit të përcaktimit dhe të paktën çdo gjashtë muaj pas kësaj date.
2. Raportet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, të publikuara nga ofruesit e platformave shumë të mëdha online, përveç informacionit të përmendur në nenin 15, të këtij ligji dhe pikën 1 të nenit 24, të këtij ligji, specifikojnë:
 - a) burimet njerëzore që ofruesi i platformave shumë të mëdha online i dedikon moderimit të përmbajtjes në lidhje me shërbimin e ofruar në Republikën e Shqipërisë, përfshirë përputhshmërinë me detyrimet e përcaktuara në nenet 16 dhe 22, të këtij ligji, si dhe për përputhshmërinë me detyrimet e përcaktuara në nenin 20, të këtij ligji;
 - b) kualifikimet dhe aftësitë gjuhësore të personave që kryejnë aktivitetet e përmendura në gjermën a), të kësaj pike, si dhe trajnimet dhe mbështetjen e ofruar për këtë personel;
 - c) treguesit e saktësisë dhe informacionin përkatës të përmendur në gjermën e) të pikës 1, të nenit 15, të këtij ligji;Raportet publikohen të paktën në një nga gjuhët zyrtare të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
3. Përveç informacionit të përmendur në pikën 2, të nenit 24, të këtij ligji, ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, përfshijnë në raportet e përmendura në pikën 1, të këtij neni informacion mbi numrin mesatar mujor të marrësve të shërbimit në Republikën e Shqipërisë.
4. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online, ose të motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i paraqesin pa vonesë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, dhe i bëjnë publikisht të disponueshme, jo më vonë se tre muaj pas marrjes së çdo raporti auditimi në përputhje me pikën 4 të nenit 37, të këtij ligji:
 - a) një raport që paraqet rezultatet e vlerësimit të rrezikut sipas nenit 34, të këtij ligji;
 - b) masat specifike të zbatjes së rrezikut të identifikuar dhe të zbatuara sipas pikës 1, të nenit 35, të këtij ligji;
 - c) raportin e auditimit të përmendur në pikën 4, të nenit 37, të këtij ligji;
 - d) raportin mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga auditimi të përmendur në pikën 6, të nenit 37, të këtij ligji;
 - e) sipas rastit, informacion mbi konsultimet e kryera nga ofruesi, në mbështetje të vlerësimeve të rrezikut dhe hartimit të masave për zbutjen e rrezikut.
5. Kur një ofrues i platformave shumë të mëdha online, ose motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, konsideron se publikimi i informacionit sipas pikës 4, të këtij neni, mund të rezultojë në zbulimin e informacionit konfidencial të këtij ofruesi, ose të marrësve të

shërbimit, të shkaktojë cënueshmëri të konsiderueshme për sigurinë e shërbimit të tij, të minojë rendin publik, ose të dëmtojë marrësit e shërbimit, ofruesi ka të drejtë të heqë një informacion të tillë nga raportet e disponueshme publikisht. Në këtë rast, ofruesi i paraqet Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale raportet e plota, të shoqëruara me një deklaratë të arsyeve për heqjen e informacionit nga raportet e disponueshme publikisht.

Neni 43

Tarifa mbikëqyrëse

1. Gjatë periudhës në të cilën i ngarkohet zbatimi i neneve 33 deri në 42, të këtij ligji, në përputhje me nenin 60, të këtij ligji, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, zbaton një tarifë mbikëqyrëse vjetore ndaj ofruesve të platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, dhe që ofrojnë shërbime për marrësit në Republikën e Shqipërisë sic përcaktohet në nenin 33, të këtij ligji.
2. Shuma totale e tarifave mbikëqyrëse vjetore, mbulon kostot e vlerësuara që Koordinatori i Shërbimeve Digjitale përballon, në lidhje me detyrat e tij mbikëqyrëse sipas këtij ligji.
3. Ofruesit e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, i nënshtrohen një tarife mbikëqyrëse vjetore për çdo shërbim të përcaktuar sipas nenit 33, të këtij ligji. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale përcakton shumën e tarifave mbikëqyrëse vjetore për secilin ofrues të platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online për vitin pasardhës, në përputhje me metodologjinë e përmendur në pikën 4, të këtij neni.
4. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale nxjerr, në përputhje me parimet e përcaktuara në pikën 5, të këtij neni, metodologjinë dhe procedurat e detajuara për:
 - a) përcaktimin e kostove të vlerësuara të përmendura në pikën 2, të këtij neni;
 - b) përcaktimin e tarifave individuale mbikëqyrëse vjetore, të përmendura në gërmat b) dhe c) të pikës 5, të këtij neni;
 - c) përcaktimin e kufirit maksimal të përgjithshëm të përcaktuar në gërmën c), të pikës 5, të këtij neni dheç) rregullat e detajuara të nevojshme për kryerjen e pagesave.
5. Aktet e nxjerra sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni respektojnë parimet e mëposhtme:
 - a) vlerësimi i shumës totale të tarifës mbikëqyrëse vjetore, merr në konsideratë kostot e përballuara gjatë vitit paraardhës;
 - b) tarifa mbikëqyrëse vjetore është proporcionale me numrin mesatar mujor të marrësve aktivë të shërbimit në Republikën e Shqipërisë, të secilës platformë shumë të madhe online ose motori shumë të madh të kërkimit online, të përcaktuar sipas nenit 33, të këtij ligji;
 - c) shuma totale e tarifës mbikëqyrëse vjetore e vendosur ndaj një ofruesi të caktuar të një platforme shumë të madhe online, ose motori shumë të madh të kërkimit online, nuk tejkalon në asnjë rast 0.5% të të ardhurave të tij neto vjetore nga ofrimi i shërbimeve të ofruara në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë vitit financiar paraardhës.
6. Tarifat individuale mbikëqyrëse vjetore të vendosura sipas pikës 1, të këtij neni, transferohen në buxhetin e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale.

SEKSIONI 6

DISPOZITA TË TJERA LIDHUR ME DETYRIMET E “DUE DILIGENCE”

Neni 44

Standardet

1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale mbështet dhe promovon zhvillimin dhe zbatimin e standardeve të përcaktuara nga organet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, të paktën në lidhje me sa vijon:
 - a) paraqitjen elektronike të njoftimeve sipas nenit 16, të këtij ligji;
 - b) modelet, standardet e projektimit dhe procesit për komunikimin me marrësit e shërbimit në një mënyrë lehtësisht të përdorshme, lidhur me kufizimet që rrjedhin nga kushtet dhe afatet, si dhe ndryshimet e tyre;
 - c) paraqitjen elektronike të njoftimeve nga sinjalizuesit e besuar sipas nenit 22, të këtij ligji, duke përfshirë përmes ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API);
 - d) ndërfaqe specifike, përfshirë ndërfaqet e programimit të aplikacioneve (API), për të lehtësuar përputhshmërinë me detyrimet e përcaktuara në nenet 39 dhe 40, të këtij ligji;
 - e) auditimin e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online sipas nenit 37, të këtij ligji;
 - f) ndëreveprueshmërinë e regjistrave të reklamave të përmendura në pikën 2, të nenit 39, të këtij ligji;
 - g) transmetimin e të dhënave përmes ndërmjetësve të reklamimit në mbështetje të detyrimeve të transparencës sipas pikës 1, gërmat “b”, “c” dhe “d” të nenit 26, të këtij ligji;
 - h) masat teknike për të mundësuar përputhshmërinë me detyrimet lidhur me reklamimin të përfshira në këtë rregullore, përfshirë detyrimet lidhur me shenjat dalluese për reklamat dhe komunikimet tregtare të përmendura në nenin 26, të këtij ligji;
 - i) ndërfaqet e zgjedhjes dhe paraqitjen e informacionit mbi parametrat kryesorë të llojeve të ndryshme të sistemeve rekomanduese, në përputhje me nenet 27 dhe 38, të këtij ligji;
 - j) standardet për masa me synim mbrojtjen e të miturve online.
2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, mbështet përditësimin e standardeve, në funksion të zhvillimeve teknologjike dhe sjelljes së marrësve të shërbimeve në fjalë. Informacioni përkatës mbi përditësimin e standardeve bëhet publikisht i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm.

Neni 45

Kodet e sjelljes

1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente për zbatimin e këtij ligji, mbështet dhe lehtëson zhvillimin e kodeve vullnetare të sjelljes për të kontribuar në zbatimin e duhur të këtij ligji, duke marrë në konsideratë në veçanti sfidat specifike që rrjedhin nga lloje të ndryshme të përmbajtjes së paligjshme dhe rreziqeve sistematike, veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Kur lind një rrezik sistematik i konsiderueshëm në kuptim të pikës 1, të nenit 34, të këtij ligji, që prek disa platforma shumë të mëdha online, ose motorë shumë të mëdhenj të kërkimit online, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, fton ofruesit e platformave online në fjalë, ose ofruesit e motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online dhe ofrues të tjerë të platformave shumë të mëdha online, motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, platformave online dhe shërbimeve të tjera ndërmjetëse, sipas rastit, si dhe autoritetet kompetente përkatëse, organizatat e shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara, të marrin pjesë në hartimin e kodeve të sjelljes, duke përfshirë përcaktimin e angazhimeve për ndërmarrjen e masave specifike për zbutjen e rrezikut, si dhe një kuadër të rregullt raportimi mbi çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre.
3. Gjatë zbatimit të pikës 1, të këtij neni, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe kur është e nevojshme, me organe të tjera, siguron që kodet e sjelljes të përcaktojnë qartë objektivat e tyre specifike, të përmbajnë tregues kyç të performancës për matjen e arritjes së këtyre objektivave dhe të marrin në konsideratë nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të interesuara, veçanërisht të qytetarëve.

Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, synon gjithashtu të sigurojë që pjesëmarrësit t'u raportojnë rregullisht Koordinatorëve të tyre të Shërbimeve Digjitale të vendit të themelimit, mbi çdo masë të marrë dhe rezultatet e tyre, të matura kundrejt treguesve kyç të performancës që ato përmbajnë. Treguesit kyç të performancës dhe angazhimet e raportimit, marrin në konsideratë ndryshimet në madhësi dhe kapacitet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm.

4. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, vlerëson nëse kodet e sjelljes përmbushin qëllimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, si dhe monitoron dhe vlerëson rregullisht arritjen e objektivave të tyre, duke marrë në konsideratë treguesit kyç të performancës që ato mund të përmbajnë. Ai publikon konkluzionet e tij. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson rishikimin dhe përshtatjen e rregullt të kodeve të sjelljes. Në rast të mosrespektimit sistematik të kodeve të sjelljes, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, fton nënshkruesit e kodeve të sjelljes të ndërmarrin veprimet e nevojshme.

Neni 46

Kodet e sjelljes për reklamat online

1. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve vullnetare të sjelljes nga ofruesit e platformave online dhe ofrues të tjerë të shërbimeve përkatëse, siç janë ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse të reklamës online, aktorë të tjerë të përfshirë në zinxhirin e vlerës së reklamimit programatik, si dhe organizata që përfaqësojnë marrësit e shërbimit, organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet përkatëse, me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës për aktorët në zinxhirin e vlerës së reklamimit online, përtej kërkesave të neneve 26 dhe 39, të këtij ligji.
2. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, siguron që kodet e sjelljes, të garantojnë një transmetim efektiv të informacionit, që respekton plotësisht të drejtat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira, si dhe një mjedis konkurrues, transparent dhe të drejtë në reklamimin online, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe atë kombëtar, veçanërisht në fushën e konkurrencës dhe mbrojtjes së privatisë dhe të të dhënave personale. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale synon që kodet e sjelljes të adresojnë të paktën sa vijon:
 - a) transmetimin e informacionit të mbajtur nga ofruesit e ndërmjetësimit të reklamimit online, të marrësit e shërbimit, në lidhje me kërkesat e përcaktuara në shkronjat b), c) dhe ç), të pikës 1, të neni 26, të këtij ligji.
 - b) transmetimin e informacionit të mbajtur nga ofruesit e ndërmjetësimit të reklamave online, drejt regjistrave sipas neni 39, të këtij ligji;
 - c) informacion domethënës mbi monetizimin e të dhënave.

Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon të gjithë aktorët në zinxhirin e vlerës së reklamave online, të përmendur në pikën 1, të këtij neni, që të miratojnë angazhimet e përcaktuara në kodet e sjelljes dhe t'i zbatojnë ato.

Neni 47

Kodet e sjelljes për aksesueshmërinë

1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, inkurajon dhe lehtëson hartimin e kodeve të sjelljes, me pjesëmarrjen e ofruesve të platformave online dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve përkatëse, organizatave që përfaqësojnë marrësit e shërbimit, organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve përkatëse, me qëllim promovimin e pjesëmarrjes së plotë, efektive dhe të barabartë, nëpërmjet përmirësimit të aksesit në shërbimet online, të cilat përmes projektimit fillestar, ose përshtatjes së mëvonshme, adresojnë nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara.
2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në koordinim me autoritetet kompetente, synon që kodet e sjelljes të kenë objektiv garantimin e aksesueshmërisë së shërbimeve, në përputhje me legjislacionin kombëtar, me qëllim maksimizimin e përdorimit të tyre nga personat me aftësi të kufizuara. Koordinator i Shërbimeve Digjitale synon që kodet e sjelljes të adresojnë të paktën objektivat e mëposhtme:
 - a) projektimin dhe përshtatjen e shërbimeve, për t'i bërë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, duke i bërë ato të perceptueshme, të përdorshme, të kuptueshme dhe të qëndrueshme;
 - b) shpjegimin e mënyrës se si shërbimet përmbushin kërkesat e zbatueshme të aksesueshmërisë dhe vënien në dispozicion të këtij informacioni për publikun, në një formë të aksesueshme, për personat me aftësi të kufizuara;
 - c) vënien në dispozicion të informacionit, formularëve dhe masave të parashikuara sipas këtij ligji, në një mënyrë që ato të jenë lehtësisht të gjetshme, të kuptueshme dhe të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 48

Protokollet e krizës

1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale nxit hartimin e protokolleve vullnetare të krizës, për trajtimin e situatave të krizës, në përputhje me pikat 2, 3 dhe 4, të këtij neni. Këto situata kufizohen rreptësisht për rrethana të jashtëzakonshme që prekin sigurinë ose shëndetin publik.
2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale mbështet dhe lehtëson pjesëmarrjen e ofruesve të platformave online, ose motorëve online të kërkimit, në zhvillimin, testimin dhe zbatimin e protokolleve të krizës. Protokollet e krizës përfshijnë një ose më shumë nga masat e mëposhtme:
 - a) paraqitjen e informacionit mbi situatën e krizës, të ofruar nga autoritetet publike ose, sipas kontekstit të krizës, nga entitete të tjera përkatëse;
 - b) sigurimin që ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse cakton një pikë kontakti specifike për menaxhimin e krizës dhe kur është e zbatueshme, kjo mund të jetë pika elektronike e kontaktit të përmendur në nenin 11, të këtij ligji, ndërsa në rastin e ofruesve të platformave shumë të mëdha online, ose motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, mund të jetë edhe zyrtari i përputhshmërisë i përmendur në nenin 41, të këtij ligji;
 - c) kur është e aplikueshme, përshtatjen e burimeve të dedikuara për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenet 16, 20, 22, 23 dhe 35, të këtij ligji, sipas nevojave që lindin nga situata e krizës.
3. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, sipas rastit, përfshin edhe autoritete të tjera, organe, zyra dhe agjenci në hartimin, testimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të protokolleve të krizës.

Ai përfshin kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, organizata të shoqërisë civile, ose organizata të tjera përkatëse në hartimin e protokolleve të krizës.

4. Koordinator i Shërbimeve Digjitale siguron që protokollet e krizës të përcaktojnë qartë të gjitha sa vijon:
 - a) parametrat specifikë për përcaktimin e rrethanës së jashtëzakonshme që protokoll i krizës trajton dhe objektivat që ai ndjek;
 - b) rolin e secilit pjesëmarrës dhe masat që ata duhet të zbatojnë gjatë përgatitjes dhe pas aktivizimit të protokollit të krizës;
 - c) një procedurë të qartë, për përcaktimin e momentit, kur protokoll i krizës aktivizohet;
 - d) një procedurë të qartë për përcaktimin e periudhës, gjatë së cilës zbatohen masat pas aktivizimit të protokollit të krizës, e cila kufizohet rreptësisht në atë që është e nevojshme për trajtimin e rrethanave të jashtëzakonshme përkatëse;
 - e) garanci për adresimin e çdo ndikimi negativ, në ushtrimin e të drejtave themelore të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe informacionit dhe të drejtën për mosdiskriminim;
 - f) një proces për raportimin publik të masave të marra, kohëzgjatjes dhe rezultateve të tyre, pas përfundimit të situatës së krizës.
5. Nëse Koordinator i Shërbimeve Digjitale, vlerëson se një protokoll krize nuk arrin të trajtojë në mënyrë efektive situatën e krizës, ose nuk garanton ushtrimin e të drejtave themelore të përmendura në gërmën e), të pikës 4, të këtij neni, ai kërkon nga pjesëmarrësit rishikimin e protokollit të krizës, përfshirë marrjen e masave shtesë.

KREU IV

ZBATIMI, BASHKËPUNIMI, SANKSIONET DHE ZBATIMI

SEKSIONI 1 — AUTORITETET KOMPETENTE DHE KOORDINATORËT KOMBËTARË TË SHËRBIMEVE DIGJITALE

Neni 49

Autoritetet kompetente dhe Koordinator i Shërbimeve Digjitale

1. Autoritetet kompetente shqiptare, për qëllimet e këtij ligji përgjegjëse për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse dhe zbatimin e këtij ligji, janë:
 - a) Autoriteti i Medias Audiovizive, organi rregullator për sektorin e medias;
 - b) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, organi rregullator për sektorin e komunikimeve elektronike;
 - c) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për mbrojtjen e të dhënave personale;
 - ç) Autoriteti i Konkurrencës;
 - d) Agjencia për mbrojtjen e konsumatorit;
 - dh) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;
- 1.1 Përveç autoriteteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, institucionet e mëposhtme janë organe administrative kompetente për lëshimin e urdhrave sipas parashikimeve në nenet 9 dhe, 10 të këtij ligji:

- a) Ministria përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore kundër terrorizmit dhe nxitjes së terrorizmit;
 - b) Ministria përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore për të drejtat e autorit në internet.
2. Koordinator i Shërbimeve Digjitale, caktohet AKEP, organi rregullator për sektorin e komunikimeve elektronike, nga lista e autoriteteve kompetente të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale është përgjegjës, për koordinimin në nivel kombëtar të zbatimit të këtij ligji dhe kontribuon në zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të dispozitave të tij, përfshirë bashkëpunimin me subjekte të tjera publike ose private, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.
 3. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale bashkëpunon me çdo autoritet publik administrativ dhe gjyqësor në kryerjen e detyrave të tyre, për qëllimet e këtij ligji. Autoritetet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, kur është e nevojshme, bashkëpunojnë ndërmjet tyre në grupe pune dhe përmes shkëmbimit të informacionit. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka të drejtë të krijojë grupe pune me qëllim përmbushjen e detyrave sipas këtij ligji.
 4. Dispozitat e zbatueshme për Koordinatorët e Shërbimeve Digjitale, të përcaktuara në nenet 50, dhe 51, të këtij ligji, zbatohen për çdo autoritet tjetër kompetent të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 50

Kërkesat për Koordinatorin e Shërbimeve Digjitale

1. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale i kryen detyrat sipas këtij ligji në mënyrë të paanshme, transparente, objektive dhe brenda afateve. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale disponon të gjitha burimet e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, përfshirë burime të mjaftueshme teknike, financiare dhe njerëzore për mbikëqyrjen efektive të të gjithë ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse që janë në fushën e kompetencës së tyre. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale ka autonomi të mjaftueshme në menaxhimin e buxhetit të tij, brenda kufijve të përgjithshëm të buxhetit, në mënyrë që të mos cënohet pavarësia e tij.
2. Gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre në përputhje me këtë ligj, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale vepron në pavarësi të plotë dhe nuk i nënshtrohet asnjë ndikimi të jashtëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë si dhe nuk kërkon, apo pranon udhëzime nga asnjë autoritet tjetër publik, apo subjekt privat.
3. Pika 2, e këtij neni, nuk cënon detyrat e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale brenda sistemit të mbikëqyrjes dhe zbatimit, të parashikuar në këtë ligj, si dhe bashkëpunimin me autoritetet e tjera kompetente. Pika 2, e këtij neni, nuk pengon ushtrimin e kontrollit gjyqësor dhe as nuk cënon kërkesat proporcionale të llogaridhënies, lidhur me aktivitetet e përgjithshme të Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, si shpenzimet financiare, ose raportimin në Kuvend, me kusht që këto kërkesa të mos cënojnë arritjen e objektivave të këtij ligji.

Neni 51

Kompetencat e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale

1. Kur është e nevojshme me qëllim kryerjen e detyrave të ngarkuara nga ky ligj, Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka kompetencat e mëposhtme mbikqyrëse/hetimore, në lidhje me sjelljet e ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse, që përfshihen në kompetencën e tij:
 - a) kompetencën për t'u kërkuar këtyre ofruesve, si dhe çdo personi tjetër që vepron për qëllime të lidhura me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tij dhe që mund të ketë informacion lidhur me një shkelje të dyshuar të këtij ligji, përfshirë organizatat që kryejnë auditimet e përmendura në nenin 37, të këtij ligji, të japin menjëherë informacionin përkatës;
 - b) kompetencën për të kryer, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor, që të urdhërojë inspektime në çdo ambient që këta ofrues ose persona përdorin për qëllime të lidhura me tregtinë, biznesin, zanatin ose profesionin e tyre, ose për t'u kërkuar autoriteteve të tjera publike që ta bëjnë këtë, me qëllim shqyrtimin, sekuestrimin, marrjen ose kopjimin e informacionit në çdo formë që lidhet me një shkelje të dyshuar, pavarësisht nga mjeti i ruajtjes;
 - c) kompetencën për t'i kërkuar çdo anëtar të personelit, ose përfaqësuesi të këtyre ofruesve ose personave, që të japë shpjegime për çdo informacion që lidhet me një shkelje të dyshuar dhe për të regjistruar përgjigjet me pëlqimin e tyre, përmes çdo mjeti teknik.
2. Kur është e nevojshme me qëllim kryerjen e detyrave të ngarkuara nga ky ligj, Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka kompetencat e mëposhtme zbatuese, në lidhje me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që përfshihen në kompetencën e tij:
 - a) kompetencën për të pranuar angazhimet e ofruesve nga këta ofrues në lidhje me përputhshmërinë me këtë ligj dhe për t'i bërë këto angazhime të detyrueshme;
 - b) kompetencën për të urdhëruar ndërprerjen e shkeljeve dhe kur është e përshtatshme, për të vendosur masa proporcionale me shkeljen dhe të nevojshme për ta përfunduar atë në mënyrë efektive, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që ta bëjë këtë;
 - c) kompetencën për të vendosur gjoka, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që ta bëjë këtë, në përputhje me nenin 52, të këtij ligji, për mosrespektim të këtij ligji, përfshirë moszbatimin e urdhrave hetimore të lëshuara sipas pikës 1, të këtij neni;
 - ç) kompetencën për të vendosur pagesa periodike penalizuese, ose për të kërkuar nga një autoritet gjyqësor që ta bëjë këtë, në përputhje me nenin 52, të këtij ligji, për të siguruar ndërprerjen e shkeljes në përputhje me një urdhër të lëshuar sipas gërmës "b" të kësaj pike, ose për moszbatim të urdhrave hetimore sipas pikës 1, të këtij neni;
 - d) kompetencën për të miratuar masa të përkohshme, ose për të kërkuar nga autoriteti gjyqësor kompetent që ta bëjë këtë, me qëllim shmangien e rrezikut të një dëmi serioz.
3. Në lidhje me shkronjat c, dhe ç, të pikës 2, të këtij neni, Koordinator i Shërbimeve Digjitale ushtron këto kompetenca zbatuese edhe ndaj personave të tjerë të përmendur në pikën 1, të këtij neni, për moszbatimin e urdhrave të lëshuara ndaj tyre sipas kësaj pike. Këto kompetenca ushtrohen vetëm pasi t'u jetë dhënë këtyre personave, në kohë të përshtatshme, i gjithë informacioni përkatës lidhur me urdhrat, përfshirë afatin e zbatimit, gjokat ose pagesat periodike që mund të vendosen dhe mjetet juridike të disponueshme.
4. Kur është e nevojshme për kryerjen e detyrave sipas këtij ligji, Koordinator i Shërbimeve Digjitale, në lidhje me ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që përfshihen në kompetencën e tij dhe kur të gjitha kompetencat e tjera sipas këtij neni për ndërprerjen e shkeljes janë shteruar, dhe shkelja nuk është korrigjuar ose vijon dhe shkakton dëm serioz, që nuk mund

të shmangët përmes ushtrimit të kompetencave të tjera të disponueshme sipas legjislacionit kombëtar, ka gjithashtu kompetencat e mëposhtme:

- a) t'i kërkojë organit drejtues të këtyre ofruesve, të shqyrtojë situatën pa vonesë, të miratojë dhe paraqesë një plan veprimi që përcakton masat e nevojshme për ndërprerjen e shkeljes, të sigurojë që ofruesi i zbaton këto masa dhe të raportojë mbi masat e marra;
 - b) kur Koordinatori i Shërbimeve Digjitale vlerëson se ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse nuk ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e gërmës a), se shkelja nuk është korrigjuar, dhe shkakton dëm serioz dhe se kjo shkelje përbën vepër penale që përfshin kërcënim për jetën ose sigurinë e personave, ka fuqi të kërkojë nga autoriteti gjyqësor kompetent, të urdhërojë kufizimin e përkohshëm të aksesit të marrësve në shërbimin përkatës ose, vetëm kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme, të urdhërojë kufizimin në ndërfaqen online të ofruesit ku ndodh shkelja.
5. Përpara paraqitjes së kërkesës sipas gërmës b), të pikës 3, të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, fton palët e interesuara të paraqesin vërejtje me shkrim, brenda një afati jo më të vogël se dy javë, duke përshkruar masat që kërkon dhe duke identifikuar subjektin/ subjektet e synuara. Ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse, subjektet e synuara dhe çdo palë e tretë që demonstroi interes legjitim, kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurë, përpara autoritetit gjyqësor kompetent. Çdo masë e urdhëruar duhet të jetë proporcionale me natyrën, seriozitetin, përsëritjen dhe kohëzgjatjen e shkeljes, pa kufizuar në mënyrë të pajustificuar aksesin në informacion të ligjshëm.
6. Kufizimi i aksesit vendoset për një periudhë prej katër javësh, me mundësinë e zgjatjes me periudha të mëtejshme me të njëjtën kohëzgjatje, kur autoriteti gjyqësor kompetent, në urdhrin e tij, i lejon Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale zgjatjen e kësaj periudhe, deri në një numer maksimal zgjatjesh të përcaktuar në urdhrin e autoritetit gjyqësor. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale e zgjat periudhën vetëm nëse, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe interesat e të gjitha palëve të prekura nga ky kufizim, si dhe të gjitha rrethanat përkatëse, përfshirë çdo informacion që mund t'i paraqitet nga ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse, të adresuarit në urdhër, si dhe çdo palë e tretë që ka një interes të ligjshëm, vlerëson se janë përmbushur të dy kushtet e mëposhtme:
- a) ofruesi i shërbimeve ndërmjetëse ka dështuar në marrjen e masave të nevojshme për ndërprerjen e shkeljes;
 - b) kufizimi i përkohshëm, nuk kufizon në mënyrë të pajustificuar aksesin në informacion të ligjshëm nga marrësi i shërbimit, duke marrë në konsideratë numrin e përdoruesve të prekur dhe ekzistencën e alternativave të përshtatshme dhe lehtësisht të aksesueshme.
7. Kur Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, vlerëson se kushtet e përcaktuara në gërmat a) dhe b), të pikës 5, të këtij neni, janë përmbushur, por ai nuk mund ta zgjasë më tej periudhën, në përputhje me pikën 5, të këtij neni, ai paraqet një kërkesë të re pranë autoritetit gjyqësor kompetent, sipas, gërma b) të pikës 1, të këtij neni.
8. Masat e marra nga Koordinatori i Shërbimeve Digjitale në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, duhet të jenë efektive, parandaluese dhe proporcionale, duke marrë parasysh natyrën, seriozitetin, përsëritjen dhe kohëzgjatjen e shkeljes ose shkeljes së dyshuar, si dhe kapacitetin ekonomik, teknik dhe operacional të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse përkatës, kur është e zbatueshme.
9. Në ushtrimin e kompetencave sipas pikave 1,2 dhe 3, të këtij neni, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale siguron respektimin e të drejtave themelore dhe parimet e

përgjithshme të së drejtës, të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, ku Shqipëria ka aderuar, në veçanti për respektimin e jetës private, dhe të drejtat e mbrojtjes duke përfshirë të drejtat për t'u degjuar dhe për akses dhe në varësi të së drejtës, për një mjet juridik efektiv të të gjitha paleve të prekura. Rregullat dhe procedurat për ushtrimin e kompetencave sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, përcaktohen me ligj dhe me aktet nënligjore përkatëse.

Neni 52

Sanksionet

1. Koordinator i Shërbimeve Digjitale ka kompetencën të vendosë sanksione në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse që përfshihen në kompetencën e tij dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ato të zbatohen në përputhje me nenin 51, të këtij ligji.
2. Sanksionet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese.
3. Shuma maksimale e gjobave që vendosen për mosrespektimin e një detyrimi të përcaktuar në këtë ligj, është deri në 6% e xhiros vjetore botërore, të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse, gjatë vitit financiar paraardhës. Shuma maksimale e gjobës që mund të vendoset për dhënien e informacionit të pasaktë, të paplotë ose mashtrues, mosdhënien e përgjigjes, ose moskorrigjimin e informacionit të pasaktë, të paplotë ose mashtrues dhe mosnënshtrimin ndaj një inspektimi, është 1% e të ardhurave vjetore ose e xhiros botërore të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse, ose personit në fjalë gjatë vitit financiar paraardhës.
4. Shuma maksimale e një pagese periodike penalizuese është 5% e xhiros, ose të ardhurave mesatare ditore në rang botëror të ofruesit të shërbimeve ndërmjetëse në fjalë gjatë vitit financiar paraardhës për çdo ditë, e llogaritur nga data e përcaktuar në vendimin përkatës.

Neni 53

E drejta për të paraqitur ankesë

Marrësit e shërbimit dhe çdo organ, organizatë ose shoqatë e autorizuar për të ushtruar në emër të tyre të drejtat e dhëna nga ky ligj, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër ofruesve të shërbimeve ndërmjetëse, duke pretenduar një shkelje të këtij ligji, pranë Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale. Koordinator i Shërbimeve Digjitale vlerëson ankesën. Kur ankesa përfshihet në kompetencën e një autoriteti tjetër kompetent, Koordinator i Shërbimeve Digjitale që merr ankesën, ia transmeton atë autoriteti përkatës. Gjatë këtyre procedurave, të dyja palët kanë të drejtë të dëgjohen dhe të marrin informacionin e duhur mbi statusin e ankesës, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 54

Kompensimi

Marrësit e shërbimit kanë të drejtë të kërkojnë, në përputhje me legjislacionin kombëtar, kompensim nga ofruesit e shërbimeve ndërmjetëse për çdo dëm, ose humbje të pësuar, si rezultat i shkeljes të detyrimeve të tyre nga këta ofrues, sipas këtij ligji.

Neni 55
Raportet e veprimtarisë

1. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, deri më 31 janar të vitit pasues për vitin e raportimit, dhe më pas çdo 12 muaj, harton raporte vjetore mbi veprimtaritë e tij sipas këtij ligji, duke përfshirë numrin e ankesave të marra në përputhje me nenin 53, të këtij ligji dhe një përmbledhje të ndjekjes së tyre. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale i vë në dispozicion të publikut raportet vjetore në një format të lexueshëm nga pajisjet, në varësi të rregullave të zbatueshme për konfidencialitetin e informacionit në përputhje me nenin 56, të këtij ligji dhe i publikon ato në faqen e tij të internetit.
2. Raporti vjetor përfshin informacionin e mëposhtëm:
 - a) numrin dhe lëndën e urdhrave për të vepruar kundër përmbajtjes së paligjshme dhe urdhrave për të dhënë informacion, të nxjerra në përputhje me nenet 9 dhe 10, të këtij ligji nga çdo autoritet gjyqësor ose administrativ kombëtar;
 - b) efektet që u janë dhënë urdhrave, siç i janë komunikuar Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale në përputhje me nenet 9 dhe 10, të këtij ligji.
3. Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, harton një raport të vetëm, që mbulon veprimtaritë e të gjitha autoriteteve kompetente dhe merr të gjithë informacionin dhe mbështetjen përkatëse të nevojshme për këtë qëllim, nga autoritetet e tjera kompetente në fjalë.

SEKSIONI 2

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR ZBATIMIN

Neni 56
Sekreti profesional

Pa cënuar shkëmbimin dhe përdorimin e informacionit të përmendur në këtë Seksion, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale, autoritetet kompetente dhe zyrtarët e tyre, nëpunësit dhe personat e tjerë që punojnë nën mbikëqyrjen e tyre, si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik i përfshirë, si audituesit dhe ekspertët, nuk do të publikojnë informacionin e marrë, ose të shkëmbyer prej tyre, në përputhje me këtë ligj si dhe të çdo informacioni, që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional.

Neni 57
Sistemi i shkëmbimit të informacionit

Koordinatori i Shërbimeve Digjitale krijon dhe mban një sistem të besueshëm dhe të sigurtë të shkëmbimit të informacionit, që mbështet komunikimet e tij me autoritetet e tjera kompetente.

Neni 58
Përfaqësimi

1. Marrësit e shërbimeve ndërmjetëse, kanë të drejtë të autorizojnë një organ, organizatë ose shoqatë, që të ushtrojë të drejtat e dhëna nga ky ligj në emër të tyre, me kusht që organi, organizata ose shoqata të përmbushë të gjitha kushtet e mëposhtme:
 - a) Të funksionojë mbi një bazë jofitimprurëse;
 - b) Të jetë themeluar në përputhje me ligjin kombëtar;
 - c) Objektivat statutore të përfshijnë një interes legjitim për të siguruar që ky ligj të respektohet.
2. Ofruesit e platformave online, marrin masat e nevojshme teknike dhe organizative, për të siguruar që ankesat e paraqitura nga organet, organizatat ose shoqatat e përmendura në pikën 1, të këtij neni, në emër të marrësve të shërbimit nëpërmjet mekanizmave të përmendur në pikën 1, të nenit 20, të këtij ligji, të përpunohen dhe të vendoset për to me përparësi dhe pa vonesë.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 59

Rishikimi

Tre vjet pas miratimit të tij, Koordinatori i Shërbimeve Digjitale do të vlerësojë dhe raportojë në Kuvend për efektin e zbatimit të këtij ligji përfshirë dhe efektin në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 60

Zbatimi i fazuar i dispozitave të këtij ligji

1. Nenet 16 deri në 32, të Kreut III, lidhur me dispozitat shtesë të zbatueshme për ofruesit e shërbimeve të hostimit, përfshirë platformat online, dispozitat shtesë të zbatueshme për ofruesit e platformave online dhe dispozitat shtesë të zbatueshme, si dhe nenet 44 deri në 48, të këtij ligji, që përcaktojnë “Dispozita të tjera lidhur me detyrimet e kujdesit të duhur”, do të hyjnë në fuqi 6 muaj pas botimit të këtij Ligji në Fletoren Zyrtare.
2. Nenet nga 33 deri në 48, të këtij ligji, për platformat shumë të mëdha online dhe të gjitha referencat ndaj platformave shumë të mëdha online dhe motorëve të kërkimit në ligj, në nenin 14, pika 5 dhe 6, nenin 19, pikat 1 dhe 2, nenin 24, pikat 2 dhe 3, nenin 29, pika 2, nenin 44, pika 1, shkronja e), nenin 45, pika 2, nenin 46, pika 2, shkronja b, nenin 48, pika 2, shkronja b, nenin 51, do të hyjnë në fuqi 12 muaj pas botimit të këtij Ligji në Fletoren Zyrtare.
3. Nenet nga 33 deri në 48, të këtij ligji për platformat shumë të mëdha online, shfuqizohen nga momenti i hyrjes në fuqi të traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Neni 61

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

